

UDHËZUES

PËR

PËRCAKTIMIN E STATUSIT TË REFUGJATIT

PËRMBAJTJA

I – HYRJE.....	3
II - ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I PROCEDURËS NË KUADËR TË MASAVE MBROJTËSE TË PARASHIKUARA ME LIGJ.....	3
Koncepte të përgjithshme	3
Kriteret për përcaktimin e statusit të refugjatit.....	4
Subjektet e përfshira në procedurë	8
Të drejtat dhe detyrimet e kërkuarit në kontekstin e procedurës.....	9
Menaxhimi i kërkesave dhe regjistrimi i tyre	10
III - INTERVISTA PERSONALE.....	12
Faza e përgatitjes	15
Hapja e intervistës	16
Rrëfimi i lirë	17
Faza e hulumtimit dhe zhvillimi i intervistës personale	18
Mbyllja e intervistës.....	20
Procesverbi i intervistës.....	20
IV - PROCESI I VENDIM-MARRJES.....	21
Analiza e çështjes nga intervistuesi.....	21
Procesi i vendim-marrjes	24
Parametrat kryesor të procedurës për shqyrtimin e kërkesave për mbrojtje nderkombetare	24
Akte dhe dispozita të tjera nën kompetencën e autoritetit përgjegjës të azilit dhe refugjatëve	
V – ANKIMIMI.....	27
Afatet e ankimit	29
Ndihma Juridike e ofruar nga shteti.....	29
Ankimimi në gjykatën administrative.....	29
VI - KOMPETENCA TË TJERA TË AUTORITETIT PËRGJEGJËS SE AZILIT DHE REFUGJATËVE.....	30
Marrëdhëniet e autoritetit përgjegjës së azilit dhe refugjatëve me institucionet e tjera	30
Menaxhimi i marrëdhënieve me Kërkuarët dhe përfaqësuesit ligjorë	30
Marrëdhëniet e AP me Qendrën e Pritjes për Azil (QPA):	30
Komunikimi i Autoritetit Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët me UNHCR.....	30
VII - ANEKSE	
Aneksi 1: Plani i intervistës	31
Aneksi 2: Formular për përcaktimin e statusit të refugjatit (për t'u plotësuar nga intervistuesi).....	34
Aneksi 3: Vendimi i gjatë dhe i shkurtuar nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët	39

Lista e shkurtimeve

BE:	Bashkimi Europian
COI:	Country of Origin Information – Informacion mbi vendin e origjinës
AP:	Autoriteti përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët
ECHR:	European Court of Human Rights –Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut
EUAA:	European Union Agency for Asylum (ish EASO : <i>European Asylum Support Office</i>)
KK:	Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët
LGBTI:	Lesbian Gay Bisexual Transgender Intersex
PKM:	Policia e Kufirit dhe Migracionit
PMF:	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës
PSR:	Përcaktimi i Statutit të Refugjatit
QPA:	Qendra e Pritjes për Azil
UNHCR:	United Nations High Commissioner for Refugees

I. HYRJE

Ky udhëzues që synon të jetë sa më praktik, është përgatitur bazuar në metodologjinë e zbatimit efektiv të **a)** Konventës së vitit 1951 për Statusin e Refugjatit dhe të Protokollit të 1967¹, dy prej instrumentave themelor për trajtimin e mbrojtjes së refugjatëve, të cilët braktisin vendet e tyre si rezultat i persekutimit, konflikteve dhe dhunës serioze të të drejtave të njeriut; **b)** të Udhëzimeve të **EUAA**, European Union Agency for Asylum (ish **EASO**: *European Asylum Support Office*)² që synojnë rritjen e rolit të punonjësve të ngarkuar me kontaktin e parë për aksesin në procedurën e azilit, për t'i garantuar kërkuarve të drejtat themelore, përmes informacionit dhe orientimit drejt procedurave të përshtatshme dhe autoriteteve kompetente, që ata të dallojnë aplikantët e mundshëm për mbrojtje ndërkombëtare apo për procedura të mëtejshme e të ndërmjetme; **c)** të zbatimit të Ligjit 10/2021 'Per Azilin ne Republiken e Shqipërisë' dhe akteve nënligjore përkatëse dhe jo vetëm.

II. ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I PROCEDURËS NË KUADËR TË MASAVE MBROJTËSE TË PARASHIKUARA ME LIGJ

II.1 KONCEPTE TË PËRGJITHSHME

Cfarë është Mbrojtja Ndërkombëtare?

Njerëzit që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare nuk i gëzojnë të drejtat themelore të njeriut si dhe nuk e kanë të garantuar sigurinë fizike në vendet e tyre të origjinës. Ata detyrohen të largohen nga rreziku i persekutimit, trajtimit çnjerëzor e degradues ose nga shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut. Legjislacioni i BE-së për azilin dhe Ligji 10/2021 ofrojnë dy forma të mbrojtjes ndërkombëtare:

a) statusin e refugjatit

¹ Libri mbi Udhëzimet për procedurat dhe kriteret për marrjen e vendimeve për statusin e refugjatit, bazuar në Konventën e 1951 dhe Protokollit të 1967, botim i UNHCR, Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët.


² EASO që ka mision të mbështesë Shtetet përmes trajtimit të unifikuar me qëllim sigurimin e cilësisë dhe informacionit të përbashkët rreth vendit të origjinës, duke i dhënë aplikantëve mundësi të barabarta për të paraqitur arsyet në kërkesat e tyre

b) statusin e mbrojtjes plotësuese.

“Refugjat” është shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose jashtë vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose dëshirë për të kërkuar mbrojtjen e atij vendi apo kthimin në atë vend, si pasojë e këtyre rrethanave, në përputhje me kriteret e nenit 1 (A) të Konventës së Gjenevës sipas së cilës statusi "refugjat" do t'i jepet cdo personi që: 1) është konsideruar refugjat sipas Rregulloreve të 12 majit 1926 dhe të 30 qershorit 1928, ose sipas Konventave të 28 tetorit 1933 dhe të 10 shkurtit 1938, Protokollit të 4 shtatorit 1939, ose Kushtetutës së Organizatës Ndërkombetare të Refugjateve; 2) Vendimet në lidhje me mospërfitimin, të marra nga Organizata Ndërkombetare e Refugjateve gjatë periudhës së veprimtarive të saj, nuk do të pengojnë statusin e refugjatit, të akorduar personave që përmbushin kushtet e paragrafit 2 të këtij seksioni;

“Mbrojtja plotësuese” është formë mbrojtjeje që i jepet shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi, që nuk i përmbush kriteret për të fituar statusin e refugjatit dhe ka arsye serioze e të bazuara të mendohet se në rast të kthimit të tij në vendin e origjinës apo në rastin e personit pa shtetësi në vendbanimin e tij të zakonshëm të mëparshëm, ai rrezikon realisht të përballlet me cenime të rënda dhe nuk ka mundësi, apo për shkak të rrezikut të tillë nuk dëshiron të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi

Skema e mëposhtme tregon që kualifikimi për statusin e refugjatit është hapi i parë që duhet shqyrtuar:



II.2 KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT TË REFUGJATIT

a) Frika e bazuar për persekutim

Konventa e Gjenevës	Direktiva e Kualifikimit	Ligji 10/2021
---------------------	--------------------------	---------------

Neni 1, seksioni A, paragrafi 2	Neni 4, paragrafi 4, Neni 9	Neni 12
---------------------------------	-----------------------------	---------

Që të mund të konsiderohet persekutim, sipas parashikimeve të ligjit 10/2021, veprimi duhet:

a) të jetë mjaftueshëm i rëndë nga natyra ose i kryer më shumë se një herë sa të përbëjë shkelje të rëndë të të drejtave themelore të njeriut, posaçërisht të të drejtave të cilat nuk mund të kufizohen sipas paragrafit 2 të nenit 15 të KEDNJ	ose	b) të jetë akumulim i masave të ndryshme, përfshirë edhe shkeljen e të drejtave të njeriut, qw është mjaftueshëm e rëndë për një individ në mënyrë të ngjashme me parashikimin e bërë në shkronjën “a”
--	-----	--

Jo çdo formë keqtrajtimi përbën persekutim. Elementët që duhet të merren parasysh për të vlerësuar nëse është arritur në nivelin e persekutimit janë të formës së:

- **aktit të dhunës fizike ose psikologjike, duke përfshirë dhunën seksuale**, nëse janë aq të shpeshta sa të çënojnë në thelb integritetin fizik të një individi ose aftësinë e tij mendore për vendimmarrje të pavarur;
- **masës ligjore, administrative, të policisë dhe/ose aktit gjyqësor**, të cilat janë diskriminuese ose janë zbatuar në mënyrë diskriminuese;
- **ndjekjes penale ose dënimit penal**, kur është kryer në shkelje të së drejtës për një proces të drejtë ligjor; që është joproporcional ose diskriminues;
- **mohimit të së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës** për rishikim të tyre dhe që rezulton në dënim joproporcional ose diskriminues;
- **ndjekjes penale ose dënimit penal për shkak të refuzimit për të kryer shërbimin ushtarak në një konflikt**, kur kryerja e shërbimit ushtarak përfshin krime ose akte që janë brenda fushës së veprimit për përjashtim nga e drejta e mbrojtjes ndërkombëtare sipas këtij ligji;
- **aktit të kryer në mënyrë të veçantë të lidhur me dhunën me bazë gjinore ose me fëmijët**, që mund të jenë, dhuna seksuale, gjymtimi i organeve gjenitale, aborti ose sterilizimi i detyruar, rekrutimi iaktit të kryer në mënyrë të veçantë të lidhur me dhunën me bazë gjinore ose me fëmijët. të miturve në forcat e armatosura, trafikimi ose prostitucioni i të miturve.

b) Arsyet për persekutim

Konventa e Gjenevës	Direktiva e Kualifikimit	Ligji 10/2021
Neni1, seksioni A, pragrafi 2	Neni 10	Neni 13

Në harmonizim të plotë me Konventën e Gjenevës dhe DK, Ligji 10/2021 përcakton pesë arsye persekutimi në bazë të cilave njihet statusi i refugjatit: raca, feja, kombësia, anëtarësia në një grup të caktuar shoqëror dhe bindjet politike, arsye të cilat nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën:

RACA	• ngiyra (lidhet me përkufizimin tradicional të racës, që përdoret për t'iu referuar grupeve të njerëzimit nga tiparet dhe pamja fizike) • prejardhja (anëtarët e një fisi, klani, komuniteti të caktuar trashëgimie) • anëtarësia në një grup të caktuar shoqëror (përfshihen pakicat dhe /ose popujt indigjen me karakteristika të përbashkëta si gjuha, feja, historia e përbashkët, kultura, zakonet, mënyra e jetesës ose vendi i banimit)
FEJA	• të pasurit besim teist, joteist apo ateist; • pjesëmarrjen apo abstenimin nga lutjet formale në publik ose në mjedise private, qoftë vetëm ose në komunitet me të tjerët • pjesëmarrjen apo abstenimin në akte të tjera besimi ose shprehjen e mendimeve me natyrë fetare • pjesëmarrjen apo abstenimin në forma të sjelljes personale ose të përbashkët, të bazuara ose të ndikuara nga çdo besim fetar;
KOMBËSIA	kombësia, nuk nënkupton shtetësinë ose mungesën e saj, por në mënyrë të veçantë duhet të përfshijë përkatësinë në një grup të karakterizuar nga: • identiteti kulturor • identiteti etnik • identiteti gjuhësor • origjinë e përbashkët gjeografike ose politike • marrëdhëniet e tij me popullsinë e një shteti tjetër;
ANËTARËSIA NË NJË GRUP TË CAKTUAR SHOQËROR	• karakteristikë të lindur ose një mjedis kulturor të përbashkët që nuk mund të ndryshohet, ose ndajnë një karakteristikë ose besim që është kaq thelbësor për identitetin ose ndërgjegjen, sa që një person nuk duhet të detyrohet ta refuzojë atë; • identitet të dallueshëm në vendin përkatës, sepse ai perceptohet si i ndryshëm nga shoqëria përreth;
BINDJET POLITIKE	• pasja e një opinioni, bindjeje ose besimi.... • në një çështje që lidhet me aktorët e mundshëm të persekutimit dhe me politikën ose metodat e tyre... • pavarësisht faktit nëse ai opinion, bindje ose besim ka ndikuar mbi kërkuesin ose jo;

b) Lidhja (për shkak të)

Konventa e Gjenevës	Direktiva e Kualifikimit	Ligji 10/2021
Neni1, seksioni A, pragrafi 2	Neni 9, paragrafi 3	Neni 12, paragrafi 3

Në vetvete aktet e persekutimit nuk e kualifikojnë personin si refugjat, me përjashtim të rastit kur ato kryhen për një (ose më shumë) nga 5 arsyet e mësipërme.

Në përputhje me përkufizimin e refugjatit, duhet të ekzistojë një lidhje ndërmjet aktit të persekutimit dhe arsyeve të këtij persekutimi, në rast të mosgarantimit të mbrojtjes ndaj këtyre akteve që mund të jetë:

- **Lidhja me aktet e persekutimit.** Në këtë rast, frika e azilkërkuesit për persekutim është e lidhur me racën e tij, fenë, kombësinë, përkatësinë në një grup të caktuar shoqëror ose me bindjen politike(reale ose të hamendësuar).
- **Lidhja me mungesën e mbrojtjes.** Ka raste kur persekutimi mund të bëhet për arsye që nuk përfshihen në përkufizimin e refugjatit, por kur tolerohet, inkurajohet ose nuk ndalohet nga përgjegjësit për mbrojtjen për një nga 5 arsyet për persekutim. Pra kërkesa për të përcaktuar lidhjen do të përmbushet edhe për mungesën e mbrojtjes.

d) Aktorët e persekutimit ose cënimit të rëndë

Konventa e Gjenevës	Direktiva e Kualifikimit	Ligji 10/2021
Neni1, seksioni A, pragrafi 2	Neni 6	Neni 15

Aktorët e persekutimit janë element kyç në procesin e përcaktimit të statusit. Persekutimi ose cënimi i rëndë duhet të përbëhen nga sjellja e një autori specifik. Aktorë të persekutimit ose cënimit të rëndë mund të jenë:

- shteti;
- palët ose organizatat që kontrollojnë shtetin ose pjesë të konsiderueshme të territorit të shtetit;
- aktorë joshitetorë, nëse mund të provohet se aktorët e përmendur në shkronjat “a” dhe “b” përfshirë edhe organizatat ndërkombëtare, nuk kanë mundësi ose nuk kanë vullnet të ofrojnë mbrojtje kundër persekutimit ose cënimit të rëndë.

e) Mbrojtja në vendin e origjinës


Konventa e Gjenevës	Direktiva e Kualifikimit	Ligji 10/2021
Neni1, seksioni A, pragrafi 2	Neni 7	Neni 16

Lista e aktorëve përgjegjës për mbrojtjen është shteruese:

1. Shteti

- Përgjegjësit e shtetit për mbrojtjen, duhet të kenë vullnetin dhe aftësinë për të dhënë mbrojtje efektive, të përhershme dhe të arritshme;
- Shteti ka detyrën të kontrollojë gjithë territorin e vendit të origjinës ose të paktën pjesën më të madhe të tij. Në disa raste, shteti mund të marrë ndihmë nga organizatat ndërkombëtare, për të përmbushur plotësisht rolin e tij mbrojtës;
- Nëse shteti ka vullnetin por jo aftësinë për të dhënë mbrojtje, ose nëse ka aftësinë por jo vullnetin për ta dhënë, mbrojtja nuk konsiderohet se i është dhënë azilkërkuesit³

2. Organizatat, partitë përfshirë këtu edhe organizatat ndërkombëtare duhet:




Për të konsideruar se partitë dhe organizatat, kontrollojnë territorin e një shteti ose një pjesë të konsiderueshme të tij, duhet vërtetuar se ato ushtrojnë funksione shtetërore përkatëse. Ky vlerësim duhet kryer bashkë me aftësinë e tyre ekzistuese për të dhënë mbrojtje, e cila duhet të jetë efektive dhe me natyrë të përhershme.

Alternativa ndaj mbrojtjes brenda vendit

Në rast se mbrojtja nuk është efektive në zonën ku banon azilkërkuesi në vendin e origjinës, duhet shqyrtuar ekzistenca e një pjese tjetër të sigurt brenda atij vendi. AP mund të përcaktojë se azilkërkuesi nuk ka nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, nëse ekziston një zonë në vendin e tij të origjinës, ku ai nuk ka frikë të bazuar nga persekutimi dhe nuk është në rrezik real që të vuajë dëme serioze.

Për të përcaktuar se mbrojtja e brendshme është e disponueshme në një pjesë të veçantë të vendit të origjinës së azilkërkuesit, duhet të përmbushen tre kritere së bashku:



Që të arrihet në përfundimin se në vendin e origjinës ka alternativë ndaj mbrojtjes së brendshme, nuk mjafton që AP të identifikojë një pjesë të sigurt të atij vendi, por edhe që azilkërkuesi të udhëtojë pa rrezik dhe në mënyrë të ligjshme drejt asaj pjese të vendit dhe të pranohet atje.

Cfarë është parimi i moskthimit dhe për kë zbatohet?

- **Parimi i moskthimit** i referohet shteteve që të shmangin në çdo lloj mënyre dëbimin apo kthimin e secilit individ tek kufijtë e territoreve apo vendeve ku mund të përballen me persekutim, dënim me vdekje, torturë, trajtim ose dënim tjetër çnjerëzor e poshtërues, edhe nëse ata mund të ndodhen në kushtet e migracionit të parregullt.
- **Në kontekstin e azilit, parimi i moskthimit** nënkupton kërkesën për t'iu garantuar hyrje në territor individëve të cilët kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, si edhe procedura azili të ndershme dhe efikase për të përcaktuar nëse personit i duhet dhënë mbrojtje ndërkombëtare apo jo.
- **Ndalimi i kthimit** është i zbatueshëm për çdo formë largimi me forcë, duke përfshirë internimin, dëbimin, ekstradimin dhe mos-pranimin në kufi. Kjo përfshin edhe kthimin indirekt që nënkupton dërgimin e një personi në një vend të tretë ku ekziston rreziku i kthimit. Asnjë azilkërkues nuk duhet të dërgohet në një vend të tretë pa pasur garanci të mjaftueshme që ai do të ripranohet në atë vend, do të gëzojë mbrojtje efektive kundër kthimit, do të ketë mundësi të kërkojë dhe të gëzojë azil dhe do të trajtohet në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare.
- **Përgjashimisht, kërkuesi mund të kthehet kur:**
 - ka arsye të bazuara për ta konsideruar atë si një rrezik për sigurinë kombëtare të vendit.
 - është dënuar me vendim të formës së prerë, veçanërisht për një krim i cili përbën rrezik për sigurinë e vendit.

II.3 SUBJEKTET E PËRFSHIRA NË PROCEDURË

[Pikat 2, 8 neni 3, pikat 1, 2, 3 neni 4 të Ligjit 10/2021]

“**Kërkuesi**” është çdo shtetas i huaj ose person pa shtetësi, që ka paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, për të cilën nuk është marrë ende një vendim përfundimtar i formës së prerë;

“**Persona që i përkasin kategorisë së veçantë**” janë fëmijët, fëmijët e pashoqëruar, personat me aftësi të kufizuara, personat e moshuar, gratë shtatzëna, prind i vetëm me fëmijë të mitur, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, viktimat e gjymtimit gjenital, LGBTI, personat me sëmundje të rënda, personat me probleme/çrregullime të shëndetit mendor⁴ ose personat, të cilët kanë qenë subjekt i torturës, përdhunimit apo ndonjë forme tjetër të dhunës psikologjike, fizike apo seksuale. (*listë jo shteruese*).

Autoritetet Përkatese

Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët (në vijim AP) është përgjegjëse për trajtimin, shqyrtimin dhe marrjen e vendimit përfundimtar të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare. Ai mbledh dhe përpunon të dhënat personale të Kërkuesve për mbrojtje ndërkombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Autoriteti përgjegjës për trajtimin e të huajve (Policia e Kufirit dhe Migracionit - në vijim PKM), është përgjegjës për trajtimin e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në kufi dhe në territory, si dhe për t'i pajisur me leje qëndrimi, sipas përcaktimeve ligjore. Në bazë të Udhëzimit Nr. 293, datë 04.06.2015, ‘*Mbi Procedurat e Trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë*’, PKM kryen procesin e vlerësimit paraprak (nëpërmjet përdorimit të një formulari të veçantë), që merret si bazë për të përcaktuar nëse një person është azil-kërkues. Pavarësisht se ky Udhëzim është miratuar para datës së miratimit të ligjit “Për azilin”, në kohën e hartimit të këtij Manuali ai është në zbatim nga PKM.

Komisioni Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët (në vijim Komisioni Kombëtar) është organi administrativ epror që shqyrton ankimet e bëra ndaj vendimeve administrative të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët. Komisioni Kombëtar është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe kompetencave të tij dhe funksionon sipas Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të tij.

II.4 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E KËRKUESIT NË KONTEKSTIN E PROCEDURËS

Kushdo që ka shprehur qëllimin për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare konsiderohet **aplikant për mbrojtje ndërkombëtare (azil-kërkues)** me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i takojnë këtij statusi.

Të drejtat e azil-kërkuesit

Cdo Kërkues duhet të ketë akses efektiv në procedurë dhe t'i sigurohet falas informacion ligjor dhe procedural, duke marrë parasysh rrethanat e tij/saj të veçanta. Dhënia e një informacioni të tillë, ndër të tjera, duhet t'u mundësojë kërkuesve të kuptojnë më mirë procedurën, duke i ndihmuar ata të përmbushin

⁴ Bëhet fjalë konkretisht për personat me probleme të shëndetit mendor, të cilët shprehin qëllimin e tyre për të paraqitur një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare (pika 4 e nenit 51 të Ligjit 10/2021).

Vendosja e pavullnetshme dhe trajtimi i pavullnetshëm të personave me problemet e shëndetit mendor, e disponueshme në: https://fra.europa.eu/sites/default/files/involuntary-placement-and-involuntary-treatment-of-persons-with-mental-health-problems_en.pdf Per me shume informacion referohuni ‘Udhëzimet e Paraburgimit’ e disponueshme në: <http://www.refworld.org/docid/503489533b8.html>

Si dhe ‘Pozioni i UNHCR-së në lidhje me para-burgimin e fëmijëve rifugjatë dhe azil-kërkues në kontekstin e migracionit’, Janar 2017, e disponueshme në: <https://www.refworld.org/docid/5885c2434.html>.

detyrimet përkatëse. Në ligjin “Për azilin”, në përputhje me kuadrin ligjor ndërkombëtar dhe europian, të drejtat dhe garancitë ligjore që synojnë mbrojtjen e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare janë:

- e drejta për t'u informuar; [Neni 25, pikat 2 dhe 3 të nenit 27, pika 4, neni 33, pika 2, neni 40, pika 2, neni 42 të Ligjit 10/2021]
- e drejta për të kontaktuar UNHCR-në (ose çdo organizatë tjetër kompetente për çështjet e mbrojtjes ndërkombëtare); [Pika 2, neni 22 dhe pika 2, neni 27 të Ligjit 10/2021]
- e drejta për të qëndruar në Republikën e Shqipërisë gjatë procedurës; [pika 1, neni 55, të Ligjit 10/2021]
- e drejta e konfidencialitetit; [Neni 95 i Ligjit 10/2021]
- e drejta për ndihmën e një përkthyesi; [Neni 23 dhe pika 1, neni 27 të Ligjit 10/2021]
- mbrojtja e parimit të unitetit familjar; [Pikat 4 dhe 5 të nenit 55 të Ligjit 10/2021]
- të përfitojë kushtet minimale të jetesës; (neni 56 i Ligjit 10/2021)
- të ketë kujdesin shëndetësor; (neni 57 i Ligjit 10/2021)
- të përfitojë shërbimet e kujdesit shoqëror;
- të përfitojë ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti; (pika 1, neni 22, pika 3, neni 7, germa ‘d’ e nenit 54, neni 58 të Ligjit 10/2021)⁵
- të ketë arsimim për kërkuesit fëmijë; (neni 59 i Ligjit 10/2021)
- të ushtrojë lirinë e mendimit dhe të besimit fetar; (neni 60 i Ligjit 10/2021)
- për punësim dhe për trajnime profesionale. (neni 61 i Ligjit 10/2021)

Detyrimet e azilkërkuesit

[Pika 7, neni 26, pika 3, neni 31 dhe neni 62 të Ligjit 10/2021]

Përveç të drejtave dhe garancive, ligji përcakton edhe detyrime për kërkuesit, të cilat janë:


- a) të plotësojë formularin për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe të bashkëpunojë për marrjen e gjurmëve daktiloskopike dhe të fotografisë, për kontrollin fizik dhe të bagazheve;
- b) të dorëzojë të gjitha dokumentet e udhëtimit, të identitetit dhe/ose prova të tjera që ka në dispozicion, që mund të kontribuojnë në marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare;
- c) t'u përgjigjet ftesave të Autoritetit përgjegjës dhe/ose organeve të tjera shtetërore përgjegjëse, si dhe të bashkëpunojë me ta në çdo fazë të procedurës;
- d) të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, si dhe me udhëzimet e dhëna ose masat e ndërmarra nga Autoriteti përgjegjës;
- e) të mos largohet nga Qendra e Pritjes ose nga vendi i caktuar nga ministria, pa lejen e Autoritetit përgjegjës derisa të përfundojë procedura e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare;
- f) t'i nënshtrohet ekzaminimit apo trajtimit mjekësor, me kërkesën e Autoritetit përgjegjës, në fushën e kujdesit shëndetësor, në rast rreziku të shëndetit publik;
- g) të njoftojë Autoritetin përgjegjës për çdo ndryshim të adresës së banimit.

II.5 MENAXHIMI I KËRKESAVE DHE REGJISTRIMI I TYRE

Paraqitja dhe regjistrimi i kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare

⁵ Udhëzimi nr. 39, datë 16.3.2022 “Për modalitetet e nevojshme organizative dhe teknike për ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare”.

Paraqitja e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare nënkupton veprimin e shprehjes, në çfarëdo mënyre dhe pranë çfarëdo autoriteti, së dëshirës së një personi për të marrë mbrojtje ndërkombëtare. Kushdo që ka shprehur qëllimin për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare, konsiderohet të jetë aplikant me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e këtij statusi.



Shumë persona që mund të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare nuk i njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe nuk kërkojnë në mënyrë aktive azil në vendin ku mbërrijnë. Kjo për shkak të situatës së tyre specifike ose për shkak të keqinformimit nga persona të tjerë, përfshirë këtu edhe kontrabandistët. Mos harroni gjithashtu, se shumë persona që mund të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare kanë frikën e persekutimit nga zyrtarët në vendin e tyre, ose gjatë udhëtimit janë trajtuar jo mirë nga zyrtarë të vendeve të tjera. Treguesit që një person mund të dëshirojë të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare shfaqen në mënyra të ndryshme.

Për t'i zbuluar më shpejt dhe më saktë treguesit, kushtojini vëmendje të veçantë elementeve në vijim:

- Kush është personi (mosha, gjinia, statusi familjar,)
- Prej nga vjen personi (vendi i origjinës, përkatësia etnike, feja dhe kombësia)
- Çfarë deklaron / nga se ka frikë personi: f Vrasja/ Ekzekutimi/ Persekutimi/Tortura / Lufta/ Kthimi
- Çfarë dëshiron personi: Ndihmë / Mbrojtje / Të takojë një përfaqësues të OKB / UNHCR / avokat

Cilat janë detajet që mund të vëzhgoni (në pamje dhe sjellje):

- Qasja / shmangia e oficerit përgjegjës/ Frika, stresi ose heshtja e pazakontë
- Gjuha e trupit siç janë shprehjet e fytyrës, qëndrimi i trupit, gjestet, toni i zërit etj.
- Pamja e jashtme, lëndimet, plagët, veshmbathjet, sendet personale etj.

Në bazë të ligjit 10/2021“Për azilin në Republikën e Shqipërisë” **Kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare**” është kërkesa për mbrojtje, e paraqitur nga shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi, që kërkon ose kuptohet se kërkon të përfitojë statusin e refugjatit ose të mbrojtjes plotësuese dhe nuk kërkon shprehimisht një lloj tjetër mbrojtjeje. Informacioni duhet dhënë **brenda një kohe të arsyeshme** dhe të jetë sa më i plotë që të jetë e mundur.

Shtetasit e huaj, ose personat pa shtetësi, mund të shprehin qëllimin e tyre për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare në momentin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë në një pikë kalimi kufitar, në një komisarjat të policisë së shtetit ose pranë autoritetit përgjegjës për çështjet e kufirit dhe migracionit - Policia e Kufirit dhe Migracionit (PKM)⁶. Informacioni mbi mundësitë për të aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare duhet të jepet edhe në qendrat e ndalimit dhe në pikat e kalimit kufitar, duke përfshirë zonat e tranzitit në kufijtë e jashtëm.

Sigurohuni të keni në dispozicion informacionin e kontaktit të autoriteteve përgjegjëse, përfshirë shërbimet e specializuara për mbrojtjen e fëmijëve dhe palët e tjera të interesit, sic janë përkthyesit, OJQ-të, UNHCR-ja si dhe cdo organizatë tjetër që ofron këshillim ligjor apo ndihmë tjetër.

Në Udhëzimin Nr. 293, datë 4.6.2015 ‘Mbi procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë’ specifikohet që zyrtarët e PKM-së kryejnë procesin e

⁶ Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse të Policisë së Shtetit dhe të shërbimeve inteligjente për mbledhjen dhe verifikimin e të dhënave (pika 2 e nenit 94 e Ligjit 10/2021).

Procedura dhe rregullat për përcjelljen e kërkesave nga BMP tek Autoriteti përgjegjës janë parashikuar në Urdhrin nr.247 date 03.06.2021 -Per Përcaktimin e procedurave dhe rregullave të dërgimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin tek autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët’.


shqyrtimit paraprak (pre-screening), nëpërmjet përdorimit të një formulari, i cili është baza për të përcaktuar nëse një person është azil-Kërkues⁷.

Afati i regjistrimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare

Shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi, i cili ka shprehur qëllimin për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, regjistrohet pranë autoritetit përgjegjës për kufirin dhe migracionin, i cili e referon rastin brenda 72 orëve pranë autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

Në rastet kur shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi paraqet kërkesë tek autoritetet përgjegjëse për trajtimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare, regjistrimi do të bëhet jo më vonë se 3 (tre) ditë pas paraqitjes së kërkesës, dhe jo më vonë se gjashtë ditë pune nëse kërkesa është paraqitur autoriteteve të tjera, siç janë policia, rojet kufitare ose pranë personelit të institucioneve penitenciare.

Nëse parashtrohen kërkesa të shumta të njëkohshme për mbrojtje ndërkombëtare nga një numër i madh i shtetasve të huaj ose personave pa shtetësi dhe që e bëjnë të vështirë në praktikë regjistrimin e kërkesave, afati zgjatet deri në 10 (dhjetë) ditë pune.



Kërkuesi duhet të plotësojë formularin, të bashkëpunojë për marrjen e gjurmëve daktiloskopike, të fotografisë, si dhe të dëshmimeve të tjera në lidhje me kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare. PKM siguron që këto të dhëna të futen në regjistrin elektronik dhe më pas i'a referon çështjen Autoritetit përgjegjës, i cili mbledh dhe përpunon të dhënat personale të Kërkuesëve për mbrojtje ndërkombëtare dhe i përdor ato për të lehtësuar bashkëpunimin me Policinë e Shtetit si dhe me organet përkatëse zbatuese që veprojnë në këtë fushë.

MOS HARRONI: aplikanti për azil nuk duhet të ndëshkohet për shkak të hyrjes apo pranisë së tij të parregullt në territor, me kusht që ai të paraqitet brenda 10- ditëve tek autoritetet shtetërore.

⁷ Ndalohet transferimi i të dhënave personale të aplikantit jashtë vendit pa miratimin me shkrim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët. Gjithashtu, të dhënat personale të mbledhura do të fshihen ose shkatërrohen pasi të arrihet qëllimi për të cilin janë mbledhur, në përputhje me parimet e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Si është parashikuar në *Udhëzimin Nr. 245 of 03.06.2021 për rregullat dhe procedurat për marrjen e informacionit dhe verifikimin e të dhënave dhe deklarimeve nga vendi i origjinës për azilkerkuesin dhe refugjatin*.

⁸ Për më shumë informacion mbi procedurën e përshpejtuar, referojuni 'Të drejtë dhe të shpejtë: Dokumenti Diskutues i UNHCR-së mbi

Procedurat e Përshpejtuar dhe të Thjeshtuara në Bashkimin Evropian, i disponueshëm në:

<https://www.refworld.org/pdfid/5b589eef4.pdf>

III: INTERVISTA PERSONALE

Intervista është një ndërveprim dinamik bashkëbisedues midis intervistuesit dhe azilkërkuesit, prandaj nuk ka receta të vlefshme për të gjitha rastet. Metoda e Intervistës për Azil është ndërtuar me pesë faza dhe secila fazë ka një qëllim të qartë. Fazat e Metodës së Intervistës për Azil duhet të zbatohen në një mënyrë që t'i përshtatet nevojave të azilkërkuesit, afateve kohore të intervistuesit dhe nevojës së tij për informacion.

III.1 Faza përgatitore

Intervistuesi, para fillimit të intervistës, studion rastin e kërkesit, duke marrë në konsideratë të gjithë dokumentacionin prezent në dosje. Kjo punë paraprake është e rëndësishme dhe e dobishme sepse:

- Bazohet në informacionin e disponueshëm në dosje, identifikon faktet materiale të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare (ato që lidhen me përkufizimin e refugjatit ose të mbrojtjes plotësuese);
- kryen kërkime në lidhje me rastin, për të patur njohuri të përditësuara të situatës së vendit të origjinës së kërkesit;
- mundëson identifikimin e hershëm të personave me nevoja të veçanta;
- identifikon fushat/temat e mundshme për t'u diskutuar gjatë intervistës;
- harton planin e intervistës që bën të mundur një intervistë të orientuar drejt qëllimeve dhe e kryer enkas për çdo azilkërkues.

Burimet për përgatitjen e çështjes

Kur përgatisni një intervistë, duhet t'u drejtoheni një larmie informacionesh dhe burimesh. Në përgjithësi, do të filloni me informacionin ekzistues në dosje, ku përfshihen dokumente të dorëzuara ose deklarime të mëparshme të bëra nga azilkërkuesi ose dokumentacioni nga autoritete specifike. Mund të përdorni informacionin nga vendi i origjinës, nga mediat sociale për të mësuar më shumë për një vend të caktuar dhe çfarëdolloj aspekti që mund të jetë me vlerë gjatë intervistës së azilkërkuesit.

Lexoni informacionin mbi dosjen e çështjes

Hapi i parë i përgatitjes së çështjes është shqyrtimi i dosjes së azilkërkuesit⁸. Në këtë fazë të procedurës së azilit, dosja e azilkërkuesit duhet të përmbajë të gjithë informacionin e dhënë nga azilkërkuesi ose përfaqësuesi i zgjedhur prej tij/saj. Dokumentet që zakonisht do të gjeni në dosjen e azilkërkuesit janë formulari i regjistrimit fillestar (pree-screening), deklarime me shkrim, rezultatet e shqyrtimit për nevoja të veçanta, përfshirë raportet mjekësore, dokumente që mbështesin kërkesën e azilkërkuesit si dhe dokumentet e identitetit. Të gjitha këto dokumente janë potencialisht të rëndësishme për intervistën dhe procesin e vendimmarrjes.

⁸ Për më shumë informacion, mund t'i referoheni *Udhëzuesit Praktik të EASO: Intervistë personale*, i disponueshëm në: <https://euaa.europa.eu/sites/default/files/public/EASO-Practical-Guide-Personal-Interview-EN.pdf>



Konsultoni Informacionin përkatës të vendit të origjinës (COI)

Kur kryeni intervistën personale, ka rëndësi jetike të kenë njohuri të thella për situatën në vendin e origjinës së azilkërkuesit, si në kohën e persekutimit të pretenduar ose të dëmtimit të rëndë, ashtu edhe aktualisht.

Hulumtimi i informacionit mbi vendin e origjinës (COI) është thelbësor për një vendim të besueshëm dhe të argumentuar mirë dhe luan një rol të rëndësishëm në fazat e ndryshme të procedurës për mbrojtjes ndërkombëtare (kur formulohen pyetjet kërkimore bazuar në rastin në fjalë; gjatë kryerjes së hulumtimit të COI-it; kur zgjedh, vlerëson dhe vërteton burime të ndryshme informacioni; kur vlerësohet COI dhe kur i referohemi COI-it në vendime). Për t'u përdorur në procedurat e mbrojtjes ndërkombëtare, COI duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e nevojshme procedurale dhe cilësore, të renditura më poshtë:

KUJTONI: Megjithatë COI është i rëndësishëm për vlerësimin e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, ai nuk dikton vendime, ai mbështet vlerësimin e provave.

Siç specifikohet me ligj, Autoriteti përgjegjës do të jetë në gjendje të marrë informacione nga burime të ndryshme, si UNHCR, Agjencia e Bashkimit Evropian për Azilin - EUAA (ish EASO) dhe organizatat përkatëse të të drejtave të njeriut. Ju lutemi gjeni më poshtë disa burime, të cilat mund të jenë të dobishme në shqyrtimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare:

- Refworld, UNHCR database: <https://ëëë.refworld.org/>
- EUAA COI publications: <https://euaa.europa.eu/coi-publications>
- ACCORD's (the COI department of the Austrian Red Cross) COI database: <https://ëëë.ecoi.net/>
- UK Home Office – Country Policy and Information Notes: <https://ëëë.gov.uk/government/collections/country-policy-and-information-notes>
- Publications of Ofpra - Office français de protection des réfugiés et apatrides: <https://ofpra.gouv.fr/fr/lhttps://ofpra.gouv.fr/fr/l-ofpra/nos-publications/les-publications-de-l-ofpraofpra/nos-publications/les-publications-de-l-ofpra>

- *Reliefëeb: Database operated by the UN Office for the Coordination of Humanitarian Affairs:*
<https://reliefëeb.int>

Identifikoni faktet materiale

Në varësi të sasisë së informacionit në dispozicion, intervistuesi duhet të identifikojë faktet materiale të aplikimit. Faktet materiale janë faktet që lidhen drejtpërdrejt me përkufizimin e refugjatit ose personit nën mbrojtje plotësuese. Mbani në konsideratë që gjatë procesit mund të dalin fakte të reja.

Identifikoni nevojat e veçanta procedurale

Duke qenë se personave që po kërkojnë mbrojtjen ndërkombëtare u është dashur të lënë shtëpitë dhe mjediset familjare, pas përballjes me sfida të vështira, shpesh ata gjenden në situata dobësie. Dobësia vjen nga rrethanat në vendlindjen e personit, nga udhëtimi, në momentin e mbërritjes në vendin pritës si dhe nga përvojat e personit në sistemin e azilit.

Në mesin e azilkërkuesve ka persona që përballen me vështirësi të shtuara, prandaj kanë nevoja të veçanta. Këto nevoja mund të jenë me natyrë procedurale dhe/ose pritjeje. Ato duhen identifikuar dhe trajtuar siç duhet në fazë sa më të hershme nga autoriteti i azilit.

Mjetet ekzistuese për identifikimin e personave me nevoja të veçanta për identifikimin e hershëm:

- Instrumenti i vlerësimit të riskut të lartë, udhëzuesi i përdoruesit, UNHCR
Ky instrument përmban një grup me tregues risku që ndihmojnë në identifikimin e azilkërkuesve të cënueshëm dhe nevojave të tyre të veçanta.
- 2. Instrumenti i EUAA-s për Identifikimin e Personave me Nevoja të Veçanta
Objektivi kryesor i këtij instrumenti është të lehtësojë identifikimin në kohë të personave me nevoja të veçanta procedurale dhe/ose pritëse. Mund të përdoret në çdo fazë të procedurës së azilit dhe në çdo fazë të procesit të pritjes. Sipas Instrumentit të EUAA-s për Identifikimin e Personave me Nevoja të Veçanta (IPSN) treguesit mund të jenë mosha, gjinia, gjendja familjare, identiteti gjinor dhe orientimi seksual, treguesit fizikë dhe mendorë si dhe ata mjedisorë.

Garancitë Procedurale për personat me nevoja specifike

[Nenet 50 dhe 51 të Ligjit 10/2021]

Personat me nevoja të veçanta, për shkak të rrethanave të tyre individuale, kanë një mundësi të kufizuar për të gëzuar të drejtat e tyre dhe për të përmbushur detyrimet e parashikuara në procedurën për njohjen e mbrojtjes ndërkombëtare. Ligji “Për azilin”, në përputhje me direktivat e BE-së, u siguron atyre garanci procedurale specifike, të tilla si: vëmendje, trajtim dhe kujdes të veçantë, pasja e një përfaqësuesi si dhe intervistimi nga personel i kualifikuar dhe i trajnuar. Është gjithashtu e rëndësishme që personave vulnerabël t’u garantohen gjithashtu:

- **identifikimi dhe raportimi në kohë i nevojave të veçanta (ose situatave të cënueshmërisë):** Është e rëndësishme që të gjithë personat që vijnë në kontakt me Kërkuesit (dmth: personeli që regjistron kërkesën për mbrojtje, personeli i ambienteve të pritjes, etj.) të kontribuojnë, bazuar në rolin dhe aftësitë e tyre, për të raportuar sa më shpejt të jetë e mundur treguesit e çdo nevojë të veçantë;
- **shqyrtimi prioritar i kërkesës së tyre për mbrojtje ndërkombëtare;**
- **mekanizmat e referimit:** i referohet aktivizimit të shërbimeve të specializuara (të llojit diagnostikues mjekësor dhe mjeko-ligjor; këshillimore dhe psikologjike, psikiatrike, psiko-sociale, antitrafikim, kundër dhunës, për mbështetjen e personave të cilët kanë qenë subjekt i ushtrimit të torturës, etj.), nga Autoriteti përgjegjës ose nga Qendra e Pritjes për Azilin (në vijim Qendra e Pritjes) ose qendrat e tjera të pritjes për Kërkuesit që mund të kenë nevojë për ndërhyrje dhe/ose trajtim;

Garancitë Procedurale për fëmijët e pashoqëruar

[Nenet 52 dhe 53 të Ligjit 10/2021]

Fëmijët e pashoqëruar, përveçse bëjnë pjesë në kategorinë e personave me nevoja të veçanta, gëzojnë edhe çdo garanci të parashikuar për ta në kuadrin e të drejtës ndërkombëtare, ku parashikohet se interesi më i lartë i fëmijës do të jetë konsiderata parësore në të gjitha veprimet në lidhje me fëmijët, që ndërmerren nga institucionet e mirëqenies sociale, qoftë publike apo private. Legjislacioni shqiptar, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, ofron garanci procedurale për fëmijët, si:

- **Caktimi i kujdestarit ligjor,**⁹ në momentin që shpreh qëllimin për të kërkuar mbrojtje ndërkombëtare;
- Vendosja e tyre në një **akomodim të përshtatshëm**, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kërkuesit fëmijë mbahen në Qendrën e Pritjes për Azil, vetëm si masë e fundit dhe vetëm pasi të jetë vërtetuar se masat e tjera alternative për kufizimin e lirisë së lëvizjes së tij/saj nuk mund të zbatohen efektivisht.
- **Fëmija nuk do të intervistohet pa praninë e punonjësit të mbrojtjes së fëmijës (ne vijim PMF),** që caktohet si përfaqësues i tij;
- **Intervista e PSR-it e fëmijëve do të kryhet nga një punonjës që ka njohuritë e nevojshme për nevojat e veçanta të fëmijës;**
- **Fëmija do të konsiderohet i tillë,** nga Autoriteti përgjegjës edhe në rast dyshimi për moshën e tij të mitur. (edhe pasi të jetë kryer një ekzaminim mjekësor për vlerësimin e moshës).

Përgatitni planin e intervistës

Të hartosh një plan interviste është detyrë kërkuese gjatë së cilës duhen marrë në konsideratë dy perspektiva të ndryshme. Nga njëra anë, duhet të përpikeni të shihni çështjen që keni në dorë nga këndvështrimi i azilkërkuesit, të reflektoni për përvojën e tij/saj dhe çfarë mund të prisni nga azilkërkuesi. Nga ana tjetër, nuk duhet të lini kurrë mënjanë procesin e vendimmarrjes dhe kërkesat e tij specifike, kështu do të jeni në gjendje t'u paraprin momenteve vendimtare të intervistës personale.

Siguroni mjedis të përshtatshëm dhe të sigurt

Autoriteti përgjegjës duhet të sigurojë ambiente të përshtatshme për intervistimin e kërkuesve, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe nevoja të tjera të veçanta. Kushtet e ambienteve duhet të garantojnë shëndetin dhe mirëqenien e individëve që i përdorin ato. Veçanërisht për të miturit rekomandohet të sigurohen dhoma të dedikuara intervistash me dekorime dhe materiale të tjera miqësore për fëmijët. Kur vlerësimi fillestar i rrezikut tregon se aplikanti ka histori të dhunës, intervistuesi duhet të marrë masat paraprake si dhe të jetë plotësisht i informuar për procedurën e evakuimit në rast alarmi për zjarr gjatë kohës së intervistës ose ndonjë emergjencë tjetër.

Siguroni intervistuesin dhe përkthyesin e duhur

Nëse aplikanti ka qenë viktimë e përdhunimit apo abuzimit seksual është jashtëzakonisht e rëndësishme t'i caktoni një intervistues dhe përkthyes të së njëjtës gjini, në mënyrë që aplikanti të mos ndihet i kërcënuar dhe jokomod.

Mbani parasysh: Studimi paraprak i çështjes mund të zhvillohet në mënyrë më të detajuar kur informacioni në dosje është tërësor. Në çdo rast, intervistuesi duhet të përgatitet për shfaqjen e mundshme të elementeve të reja gjatë intervistës, të cilat nuk kanë qenë të pranishme ose të parashikuara në momentin e studimit të dosjes.

⁹ Që është punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve nga bashkia apo njësia administrative, ne rastin kur nuk është caktuar ende kujdestar ligjor për të miturin e pashoqëruar (pika 1 (ç) e nenit 29 të Ligjit nr. 10/2021).

III.2 Faza e hapjes së intervistës

Qëllimi i kësaj faze është:

- (a) të ndërtohet një marrëdhënie besimi me azilkërkuesin;
- (b) të informohet azilkërkuesi për të drejtat dhe detyrimet, qëllimin dhe kohëzgjatjen e intervistës;
- (c) të merret informacioni bazë për profilin, biografinë dhe aftësitë e rrëfimit të azilkërkuesit.

Hapa të rëndësishme të fazës së prezantimit

1 Përshëndesni kërkuesin në mënyrë profesionale dhe prezantoni personat e pranishëm (p.sh. përkthyesi, përfaqësuesi ligjor ose kujdestari¹⁰, stafi mbështetës, etj.) si dhe shpjegoni rolet e tyre (për të krijuar, që në fillim, një klimë besimi dhe për të zvogëluar çdo ndjenjë tensioni dhe ankthi).

2 I jepni kërkuesit informacione rreth intervistës:

- qëllimi i intervistës;
- struktura e intervistës;
- regjistrimi audio ose video i intervistës;
- konfidencialitetin e informacionit;
- mundësia e pushimeve;
- detyrimi për të bashkëpunuar dhe për të dhënë informacione të vërteta;
- vendimet që mund të miratojë Autoriteti përgjegjës;
- mundësinë e ankimimit, në rast se kërkuesi nuk është i kënaqur me vendimin e marrë.

3- Verifikoni që përkthyesi dhe kërkuesi e kuptojnë njëri tjetrin (duke lejuar një bisedë të shkurtër mes tyre mbi tema neutrale).

Ndërtoni marrëdhënie besimi, bazuar në empati

Për të arritur një nivel të mirë empatie, është e nevojshme që intervistuesi të jetë i vetëdijshëm për pabarazinë e pushtetit që ekziston midis tij/saj dhe kërkuesit dhe për faktin se kjo pabarazi, e cila nuk mund të eliminohet, mund të prodhojë një sërë efektesh shtrembëruese në komunikim. Vënia në praktikë e stileve bazë të komunikimit si të qenit fleksibël, i/e durueshëm, i/e qetë dhe një dëgjues/e aktiv/e ndihmon për të krijuar një atmosferë të mirë komunikimi. Për krijimin e situatës së ndërveprimit pozitiv me kërkuesin, këshillohet që intervistuesi të marrë këto masa:

- **të mbajë një qëndrim profesional** (që do të thotë të shfaqë një qëndrim jogjykses dhe të mbetet i paanshëm në qasjen dhe reagimin e tij/saj ndaj deklaratave të Kërkuesit);
- **të shfaqë empati** (duke përdorur një ton dhe gjuhë të përshtatshme, duke përfshirë gjuhën e trupit);
- **të mbajë një qëndrim jogjykses** (duhet të përdorni një ton të përshtatshëm gjatë intervistës, kureshtar në qasjen dhe reagimet ndaj deklaratave të kërkuesit, duke përfshirë kur ka, p.sh. indikacione për mospërputhje, dokumente të falsifikuara ose akte të përjashtueshme).
- **të shmangë veshjen e rrobave që nuk respektojnë ndjenjën e modestisë ose të fesë së kërkuesve.** (Një kontekst besimi, në të cilin Kërkuesi mund të ndihet i/e dëgjuar me profesionalizëm dhe respekt, ka një ndikim pozitiv në cilësinë dhe sasinë e informacionit që do të mblidhet gjatë intervistës).
- **të mbajë një qëndrim neutral** (të përpiqet të jetë sa më objektiv dhe i qartë që të jetë e mundur dhe nuk duhet të ndikohen nga raste të tjera ose bindjet apo opinionet e tyre personale).

¹⁰ Për më shumë informacion, ju lutemi referojuni Udhëzuesit Praktik të EASO: Intervistë personale, i disponueshëm në: <https://euaa.europa.eu/sites/default/files/public/EASO-Practical-Guide-Personal-Interview-EN.pdf>

Shënim: Shmangni keqkuptimet për shkak të supozimeve, vlerave ose pritjeve të lidhura me kulturën. Edhe nëse intervistuesi ka njohuri të mira për kulturën dhe traditat e aplikantit, kjo nuk do të thotë që ai dhe aplikanti e kuptojnë njëri-tjetrin automatikisht.

III.3 Faza e rrëfimit të lirë

Faza e rrëfimit të lirë do t'i japë azilkërkuesit mundësinë për të folur me sa më shumë detaje dhe saktësi për arsyet pse ka kërkuar mbrojtje ndërkombëtare. Kjo qasje do të ndihmojë edhe të nxitet kujtesa dhe përqendrimi i tij/saj. Kjo fazë duhet të përsëritet gjatë intervistës, në varësi të strategjisë suaj për intervistën dhe nevojës për informacion.

Përkthyesi luan një rol thelbësor gjatë intervistës, pasi bën të mundur komunikimin midis intervistuesit dhe kërkuar.

- **Përkthyesi** përkthen drejtpërdrejt atë që thuhet. Megjithatë, është e rëndësishme që intervistuesi t'i drejtohet aplikantit drejtpërdrejt (në vetën e parë) dhe jo përmes përkthyesit.
- **Përkthyesi** nuk duhet të shprehë mendimin ose t'i ofrojë këshilla zyrtarit të rastit ose kërkuar.
- **Përkthyesi** nuk duhet të ketë lidhje me aplikantin.
- **Intervistuesi**, duhet të konfirmojë se përkthyesi i përzgjedhur është në gjendje të ofrojë një interpretim të saktë dhe të paanshëm në përputhje me procedurat kombëtare. Intervistuesi duhet të monitorojë përkthyesin gjatë punës së tij dhe të sigurohet që përkthyesi të veprojë në mënyrë neutrale dhe të paanshme.

Shënim Bashkëpunimi i mirë midis kërkuar, përkthyesit dhe intervistuesit, mundëson krijimin e një komunikimi të rrjedhshëm, me një klimë besimi, si dhe parandalon keqkuptimet gjuhësore që mund të komprometojnë intervistën.

Qëllimi i fazës së rrëfimit të lirë është nxjerrja e sa më shumë informacioneve të besueshme dhe të sakta, duke i dhënë mundësi aplikantit të bëjë një rrëfim personal të pandërprerë për arsyet e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.

- **Jepini azilkërkuesit** mundësinë të tregojë pa ndërprerje variantin personal të arsyeve për ikjen nga vendi i origjinës, duke ia paraqitur temën në mënyrë neutrale, duke dëgjuar në mënyrë aktive dhe duke mbajtur shënim pikat që duhen ndjekur në fazën tjetër.
- **Inkurajoni aplikantin** duke u bërë një dëgjues aktiv.
- **Konfirmoni** që gjërat kuptohen
- **Vlerësoni** informacionin dhe të përditësoni planin e intervistës.
- **Hulumtoni** temat e rëndësishme duke e filluar nga prezantimi, pyetjet e hapura, pyetjet e fokusuara ose të mbyllura nëse është nevoja, bëni përmbledhjen dhe në fund mbylleni temën.

III.4 Faza e hulumtimit dhe zhvillimi i intervistës personale

[Pikat 4, 7 të nenit 30, të Ligjit 10/2021]

Qëllimi i kësaj faze është detyrim i përbashkët ndërmjet autoriteteve dhe azilkërkuesit për të vërtetuar faktet e aplikimit që do të thotë se intervistuesi duhet:

- **të hulumtojë** të gjitha çështjet që lidhen me kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare
- **të sqarojë** të gjitha keqkuptimet dhe problemet e mundshme me besueshmërinë.

- **të njihet** me informacionin relevant të vendit të origjinës që mund ta ndihmojë për të kuptuar situatën e kërkuarit dhe për t'i konfirmuar mospërputhjet me elementët e deklaratave të tij;
- **të ndihmojë** kërkuarin të japë një pasqyrë të plotë të historisë së tij duke parashtruar pyetje të përshtatshme;
- **t'i japë kërkuarit** mundësinë për të sqaruar çdo mospërputhje të mundshme.

Është e këshillueshme që intervistuesi të zbatojë rekomandimet e mëposhtme:

1- Zbatimi korrekt i teknikave të intervistës
• bazoni intervistën në rrëfim të lirë, prezantoni çdo temë me radhë, bëhuni një dëgjues aktiv; • gjatë rrëfimit të lirë, bëni pyetje për analizë, sqarim dhe verifikim të thellë, duke shmangur pyetjet sugjестive ose gjykuese; • bëni pyetje të shkurtra dhe të thjeshta sipas aftësive dhe nivelit arsimor të kërkuarit; • përdorni qasjen "hinkë " (<i>duke filluar nga rindërtimi i një ngjarjeje/fakti/situatë dhe më pas duke thelluar në mënyrë progresive aspektet përkatëse individuale</i>); • në rast se shfaqen një ose disa kontradikta, bëjini të qarta tek kërkuari dhe ofrojini mundësinë për të dhënë shpjegime/sqarime të mëtejshme; • mbani qëndrim të vetëdijshëm, mendjehapur, për dallimet kulturore ekzistuese dhe ndikimin që ato mund të kenë në komunikim; • jepini kohë të mjaftueshme kërkuarit për t'u përqendruar dhe reflektuar.
2- Mbledhja e informacionit të nevojshëm për të vlerësuar kredibilitetin
• Intervistuesi duhet të mbledhë të gjitha faktet materiale, të cilat janë faktet që lidhen drejtpërdrejt me përkufizimin e refugjatit (<i>neni 1(A)(2) i Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe direktivat e BE-së (neni 2(d) për personin që kualifikohet për statusin e refugjatit dhe neni 2(f) dhe neni 15 të Direktivës 2011/95/BE për personin që kualifikohet për mbrojtje plotësuese</i>) dhe që shkojnë në thelb të kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare. Kjo ka të bëjë me të gjitha deklaratat (<i>dokumentet ose provat</i>) e kërkuarit që mund të konsiderohen të besueshme dhe, për rrjedhojë, të merren parasysh në analizën e frikës së bazuar për persekutim apo të rrezikut real të cenimit të rëndë.
3- Mbledhja e informacionit të rëndësishëm për vlerësimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare
• merrni të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga kërkuari duke i ofruar mundësinë për të sqaruar mbi dokumentet e paraqitura dhe çdo arsye për mosparaqitjen e dokumenteve të tjera potencialisht relevante; • bashkëpunoni për të nxjerrë në pah të gjitha faktet thelbësore, veçanërisht çfarë ka ndodhur (<i>aktet e përndjekjes/cenimit të rëndë</i>); kush është viktimë e persekutimit/ cenimit të rëndë; kush është autori i përndjekjes/ cenimit të rëndë; kur dhe ku ka ndodhur (<i>pikat e referimit kronologjik dhe hapësiror</i>); pse ndodhi, d.m.th, këndvështrimi personal i kërkuarit, se pse ai/ajo ose të tjerët kanë qenë - ose ka të ngjarë të bëhen - viktimë të persekutimit/ cenimit të rëndë;¹¹ • pyesni se nga çfarë frikësohet kërkuari në rast të kthimit në vendin e origjinës ose në vendbanimin e mëparshëm;

¹¹ Kjo është e rëndësishme për të verifikuar se ekziston një lidhje me një nga pesë arsyet e persekutimit (racë, fe, kombësi, grup shoqëror, opinion politik) të përcaktuara si bazë për njohjen e statusit të refugjatit nga Konventa e Gjenevës e vitit 1951.

- **sqaroni** cilat janë karakteristikat personale të kërkuesit, aktuale ose ato që mund të jenë arsye për përndjekje ose cënimin e rëndë;
- **pyesni**, veçanërisht në rastin e persekutimit nga aktorë joshitetorë, nëse kërkuesi ka kërkuar mbrojtje nga vendi i tij dhe nëse një mbrojtje e tillë është realisht e disponueshme;
- mblidhni çdo element tjetër të dobishëm për vlerësimin e njohjes së mbrojtjes plotësuese, bazuar në kriteret e parashikuara në ligj (neni 14);
- **eksploroni** ekzistencën e mundshme të arsyeve serioze humanitare.

4- Mbledhja e informacionit për të vlerësuar përjashtimin nga mbrojtja ndërkombëtare

- **identifikoni** cilat veprime dhe/ose sjellje janë të rëndësishme për përjashtimin dhe vazhdoni me një hetim të veçantë për secilën prej tyre duke përdorur metodën "**hinkë**";
- **shqyrtoni** çdo veprim/sjellje individuale, sipas modelit të pyetjes **kush-çfarë-si-kur-ku**: **Kush** (*kush janë subjektet e përfshira dhe cili ishte kontributi individual i Kërkuesit*)? **Çfarë** (*çfarë ndodhi dhe cili ishte rezultati*)? **Si** (*si veproji Kërkuesi ose si kontribuoi ai/ajo në veprimin e tjetrit*)? **Kur** (*në çfarë kohe; çfarë moshe kishte Kërkuesi; ngjarja ka ndodhur gjatë një konflikti të armatosur*)? **Ku** (*ku kanë ndodhur faktet*)?
- **hetoni** pozicionin personal dhe përfshirjen aktuale të kërkuesit nëpërmjet elementëve të mëposhtëm:
- nëse kërkuesi i përket një organizate ose grupi të përfshirë në akte që mund të çojnë në përjashtim; metodat e rekrutimit;
- çdo trajnim i marrë me përshkrime të hollësishme;
- kronologjinë e pjesëmarrjes së tij efektive;
- rolin e luajtur nga kërkuesi në organizatë;
- nivelin e ndërgjegjësimit për natyrën e akteve të kryera nga grupi;
- ekzistenca e mundësive konkrete për t'u larguar nga organizata ose grupi;
- vlerësoni me kujdes, momentin¹² në të cilin do të bëni pyetje në lidhje me qëllimet e kërkuesit dhe shkallën e ndërgjegjësimit të tij/saj për veprimet e kryera;

III.5 Faza e mbylljes së intervistës

Procesverbali i intervistës

[Pikat 4, 5 dhe 6 të nenit 30, të Ligjit 10/2021]

Në çdo rast, Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët mban një procesverbal gjatë intervistës personale me kërkuesin, i cili nënshkruhet nga kërkuesi për të konfirmuar vërtetësinë e tij, pasi i është komunikuar më parë përmbajtja në gjuhën që ai kupton. Nëse kërkuesi refuzon të nënshkruajë procesverbalin, arsyet për këtë refuzim pasqyrohen në dosjen e kërkuesit. Refuzimi për të nënshkruar procesverbalin nuk ndikon në vendimin përfundimtar. Ligji 10/2021 "Për Azilin në R.SH" parashikon që kur çmohet e arsyeshme, intervista personale mund të kryhet edhe me regjistrim audio ose audiovizual, me kusht që kërkuesi të jetë i informuar paraprakisht lidhur me të. Në transkript raportit duhet të shkruhet plotësisht dhe me besnikëri, pa përmbledhur, modifikuar, korrigjuar, zhvendosur ose integruar asnjë nga pyetjet, përgjigjet apo deklaratat. Në fund të intervistës, kërkuesi nënshkruan raportin për të konfirmuar vërtetësinë e tij, pasi i është komunikuar më parë përmbajtja e procesverbalit të transkriptuar me ndihmën e një përkthyesi, ku i garantohet e drejta që të bëjë komente ose të japë shpjegime në lidhje me ndonjë keqkuptim të paraqitur në fund të intervistës, ose brenda një kohe të arsyeshme, para se Autoriteti Përgjegjës të marrë vendim. Disa hapa të rëndësishme që këshillohet të ndiqen nga zyrtari i rastit:

¹² Është e rëndësishme të mbani mend se parashikimi shumë herët i momentit në të cilin bëhet kjo lloj pyetje, si dhe ndërprerja e rrëfimit të lirë të aplikantit, mund të jetë kundërproduktive.

<i>Në fazën përgatitore, çfarë duhet të bëni që të hyni në intervistë në mënyrën më të mirë?</i>	Para intervistës është me rëndësi të përgatiteni mendërisht që do të merrni pjesë dhe të zgjidhni situatat e vështira. Për ta bërë këtë, duhet të identifikoni temat potenciale që mund të jenë delikate. Mendoni paraprakisht se si mund të përgjigjet emocionalisht azilkërkuesi.
<i>Në fazën e hapjes, ç'informacion mund t'i jepni një azilkërkuesi të brishtë?</i>	Duhet ta informoni azilkërkuesin për temat që do të diskutohen në intervistë. Gjithashtu, i spjegohet azilkërkuesit se pjesëmarrësit në intervistë kanë detyrimin të mbajnë të fshehtë atë duke e ndihmuar azilkërkuesin të ketë më shumë besim.
<i>Gjatë të gjitha fazave të intervistës, si duhet të trajtoni emocionet tuaja dhe ato të azilkërkuesit?</i>	<i>Ruani objektivin e synuar dhe mbani distancë emocionale.</i> Gjatë intervistës duhet të jeni të aftë të përballoni emocionet tuaja për të qenë asnjans, të vëmendshëm dhe të fokusuar. Mënyra më e mirë është ta lejoni azilkërkuesin ta tregojë historinë e tij/saj. Në rast se shfaqni reagime emocionale, do të jetë shumë më e vështirë që azilkërkuesi të shprehë veten lirisht. Azilkërkuesi duhet të ndiejë se intervistuesi është aq i fortë sa ta dëgjojë historinë e tij dhe se nuk po e gjykon. <i>Vëreni emocionet e azilkërkuesit.</i> Reagimet emocionale të azilkërkuesit nuk duhen shpërfillur. Intervistuesi empatik i merr parasysh emocionet e azilkërkuesit. Këtë duhet ta bëni në mënyrë asnjansë, për shembull duke përdorur komunikimin joverbal dhe duke mos përdorur shprehjet si “E kuptoj çfarë ndjeni” sepse nuk janë as të vërteta, as të dobishme.
<i>Cilat qëndrime profesionale, gjatë të gjitha fazave të intervistës, mund t'ju ndihmojnë të përballoni një azilkërkues që qan?</i>	Kini durim dhe merreni shtruar. Në rast se azilkërkuesi po qan, nuk ka nevojë ta ngutni. Është reagim normal, prandaj duhet ta pranoni pa u nxehur. Duhet t'i lini azilkërkuesit hapësirë për të shfaqur emocionet dhe t'i jepni kohë të qetësohet. Mos u trembni nga disa minuta të kaluara në heshtje ndërsa prisni që azilkërkuesi të rimarrë veten. Mund edhe t'i ofroni azilkërkuesit diçka për të pirë dhe shami hundësh kur e shikoni të nevojshme.
<i>Gjatë të gjitha fazave të intervistës, cila strategji mund të përdoret për t'i krijuar siguri azilkërkuesit?</i>	Në rast se është nevoja, kthehuni tek hyrja e intervistës. Mund t'i kujtoni azilkërkuesit se ndodhet në mjedis të sigurt dhe se të gjithë pjesëmarrësit në intervistë janë profesionistë. Ata janë mësuar të dëgjojnë histori të vështira, pa gjykuar. Mund edhe ta informoni azilkërkuesin se cilat tema mbeten ende për të hetuar.
<i>Në fazën përmbyllëse, çfarë do t'i thonit një azilkërkuesi pas një interviste emocionalisht të vështirë?</i>	Pas një interviste emocionalisht të vështirë, është me rëndësi ta sillni azilkërkuesin në të tashmen. Për ta bërë këtë, mund ta mbyllni intervistën duke përmendur të ardhmen ose një situatë të këndshme. Mund ta mbyllni intervistën duke theksuar trimërinë e azilkërkuesit dhe ta falënderoni që e ndau historinë e tij/saj me ju.

IV. PROCESI I VENDIM-MARRJES

IV.1. Analiza e çështjes nga intervistuesi

Shqyrtimi i aplikimeve dhe marrja e vendimeve për mbrojtje ndërkombëtare duhet të jenë gjithmonë individuale, objektive dhe të paanshme.

Analiza që bëhet rast pas rasti duhet të marrë parasysh këto elemente kyçe:

- situatën individuale e azilkërkuesit, përfshirë faktorët si e shkuara, gjinia dhe mosha;
- azilkërkuesi duhet të jetë jashtë vendit të tij të origjinës;
- veprimet dhe kërcënimet ndaj të cilave azilkërkuesi ka qenë ose mund të jetë i ekspozuar;
- të gjithë informacionet e rëndësishme që lidhen me vendin e origjinës në momentin e marrjes së vendimit për alikimin;
- nëse mbrojtja në vendin e origjinës është e disponueshme dhe e arritshme.

Nevojat për mbrojtje në fillim vlerësohen lidhur me zonën ku azilkërkuesi ka vendbanimin në vendin e origjinës. Zona e vendbanimit në vendin e origjinës identifikohet nisur nga fortësia e lidhjeve të azilkërkuesit me një zonë të caktuar në atë vend. Zona e vendbanimit mund të jetë vendi ku azilkërkuesi është lindur ose rritur, ose një zonë tjetër ku azilkërkuesi ka banuar dhe ka jetuar, prandaj ka lidhje të forta me të.

Më poshtë jepen hapat që këshillohen të ndiqen nga intervistuesi në analizimin e një çështjeje.

Hapi i parë – Identifikimi i fakteve materiale / relevante:

Intervistuesi sipas intervistës, bën një mbledhje të kujdesshme të fakteve që disponon, të cilat janë të nevojshme për të identifikuar faktet materiale, ose ato rrethana e ngjarje që lidhen me kërkesën për njohjen e një prej formave të mbrojtjes ndërkombëtare. Identifikimi i duhur i fakteve materiale është vendimtar si për kredibilitetin ashtu edhe për vlerësimin e rrezikut. Kur intervistuesi pranon një fakt material, ai mund të vlerësojë nevojën për mbrojtje ndërkombëtare bazuar në atë fakt.	▪ Profili i kërkesit ▪ Deklaratat e kërkesit ▪ Frika e shprehur në rast kthimi në vendin e origjinës ose të vendbanimit të mëparshëm ▪ Dokumentacioni/provat e paraqitura nga kërkesi
---	--

Hapi i dytë: Kredibiliteti dhe vlerësimi i rrezikut

Vlerësimi i kredibilitetit konsiston në shqyrtimin e fakteve materiale bazuar në analizën e kredibilitetit të brendshëm (në nivelin e detajeve të fakteve të rrëfyera; në praninë e elementeve "ndijore" në historinë dhe përvojat personale) dhe kredibilitetit të jashtëm (p.sh. për përputhjen me informacionin e disponueshëm në vendin e origjinës - COI - dhe/ose për përputhjen me deklaratat e palëve të treta). Vlerësimi i rrezikut është kur intervistuesi bën një	<u>Kredibiliteti i brendshëm:</u> ▪ Mjaftueshmëria dhe specifiteti i detajeve ▪ Konsistenca <u>Kredibiliteti i jashtëm:</u> ▪ konsistencë me informacionin e vendit të origjinës ▪ përputhje me informacionin e njohur
---	--

analizë të rrezikut bazuar në faktet materiale të vërtetuara në lidhje me standardin e provës¹³ që lidhet me vërtetimin e frikës së bazuar për persekutim apo rrezikut real të cenimit të rëndë. Standardi më i zakonshëm i provës i aplikuar në vlerësimin e frikës së bazuar për persekutim apo rrezikut real të cenimit të rëndë është <i>‘shkalla e arsyeshme e gjasave. Standardi i zbatueshëm i provës në çdo rast duhet të jetë më i ulët se ‘përtej dyshimit të arsyeshëm’.</i>	përgjithësisht ▪ përputhje me provat e tjera Dokumentat: ▪ rëndësia ▪ ekzistenca ▪ përmbajtja ▪ forma ▪ natyra
---	---

Hapi i tretë: Analiza ligjore e përfshirjes në një nga format e mbrojtjes ndërkombëtare :

Analiza e frikës së bazuar për persekutim apo rreziku real i cenimit të rëndë që kërkuesi mund të ekspozohet nëse kthehet në vendin e origjinës është faza përfundimtare e shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.	KINI PARASYSH:
Rreziku i ardhshëm shqyrtohet bazuar në faktet që intervistuesi ka në dorë në momentin e marrjes së vendimit. Fakti që një kërkues ka qënë objekt persekutimi apo rreziku real të cenimit të rëndë është një tregues serioz i frikës së bazuar të kërkuesit për persekutim apo rreziku real të cenimit të rëndë. Është gjithashtu e rëndësishme të kihet parasysh se mungesa e persekutimit të mëparshëm nuk do të thotë se nuk ka rrezik në të ardhmen, siç mund të jetë për shembull rasti i një refugjati në vend, (sur-place). Në vlerësimin e përfshirjen në statusin e refugjatit duhet të verifikohet nëse ekzistojnë elementet e parashikuara në Konventën e Gjenevës e vitit 1951. Përfshirja në statusin e refugjatit kërkon ekzistencën e lidhjes shkakësore (nexus), një lidhje ndërmjet aktit¹⁴ të persekutimit dhe arsyeve të këtij persekutimi, siç përcaktohet edhe në pikën 3 të nenit 12 të ligjit shqiptar për azilin. Mbrojtja plotësuese është një formë shtesë e mbrojtjes ndërkombëtare që është plotësuese me statusin e refugjatit. Kjo do të thotë që një personi duhet t'i jepet mbrojtje plotësuese vetëm nëse nuk plotësohen kriteret për statusin e refugjatit. Në lidhje me mbrojtjen plotësuese duhen sqaruar dhe analizuar me kujdes dy elementët: ‘rreziku real’ dhe ‘cënimi i	Përfshirja në një prej formave të mbrojtjes ndërkombëtare duhet të vlerësohet edhe në rastet kur konstatohet një fakt i vetëm material, i cili është i rëndësishëm për qëllimet e mbrojtjes ndërkombëtare (p.sh. prania e thjeshtë e një shtetësie të caktuar, prejardhja gjeografike, etnia, feja ose gjinia mund të përcaktojnë nevojën për analizën ligjore të përfshirjes). Nëse gjatë intervistës janë identifikuar profile që duhet të konstatohet ndonjë element përjashtimi, duhet të vazhdohet me analizën ligjore të këtyre elementeve, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në

¹³Udhëzuesi praktik i EASO: *Vlerësimi i provave*, i disponueshëm në: <https://euaa.europa.eu/sites/default/files/public/EASO-PracticalGuide-Evidence-Assessment.pdf>

¹⁴ Akti i persekutimit kryhet për një (ose më shumë) nga pesë arsyet (kombësia, raca, feja, bindja politike dhe grupi të caktuar shoqëror) të Konventës së Gjenevës të vitit 1951.

rëndë’. Kërkesa e lidhjes shkakësore ('për shkak të') për mbrojtjen plotësuese i referohet lidhjes shkakësore midis dhunës pa dallim dhe cënimit (kërcënim serioz për jetën e një personi)¹⁵.	nenin 19 dhe 21 të Ligjit 10/2021 “Për azilin”.
---	--

IV.3. Procesi i vendimmarrjes

Procesi i vendimmarrjes mund të shihet si një process me dy faza: **vlerësimi i provave** (vërtetimi i fakteve) dhe **vlerësimi ligjor** (zbatimi i ligjit). Pasi vërtetohen rrethanat e fakteve, intervistuesi i ngarkuar me dosjen duhet të vlerësojë nëse përmbushen kushtet thelbësore të parashikuara në legjislacionin vendas për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare.

Faza e parë duhet të përfundojë me të kuptuarit qartë se cilat fakte materiale janë pranuar (**vlerësimi i besueshmërisë**) dhe bazuar në ato fakte, shkalla e probabilitetit që azilkërkuesi t’u nënshtrohet trajtimeve që mund të konsiderohen përndjekje ose dëme serioze (**vlerësimi i rrezikut**).

Në fazën e dytë, intervistuesi duhet të marrë faktet materiale të pranuar bashkë me rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe të zbatojë dispozitat ligjore përkatëse.

Afatet për marrjen e vendimit nga Autoriteti përgjegjës

[Neni 28 i Ligjit 10/2021]

Sipas legjislacionit në fuqi, Autoriteti përgjegjës, si rregull, përfundon procedurën për përcaktimin e statusit të mbrojtjes ndërkombëtare brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e paraqitjes së kërkesës. Ky afat mund të zgjatet edhe për 3 (tre) muaj të tjerë, në rast të çështjeve komplekse, të një numri të madh kërkesash, ose për shkaqe të tjera, por në çdo rast Autoriteti përgjegjës përfundon procedurën e ekzaminimit, maximumi, brenda 21 muajsh nga depozitimi i kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.

Përmbajtja e vendimit

[Pika 2 e nenit 33 të Ligjit 10/2021]

Vendimi jepet me shkrim dhe duhet të përmbajë:

- **pjesën hyrëse** (që përmban: *emrin e organit publik që nxjerr aktin; palëve të cilave u drejtohet akti; datën e miratimit dhe bazën ligjore*);
- **pjesën arsyetuese**;
- **dispozitivin** (që përmban: *pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur; kohën e hyrjes në fuqi të aktit; të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet dhe afatet ligjore për paraqitjen e ankimit*).

IV.3 Parametrat kryesor të procedurës për shqyrtimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare

Identifikimi i fakteve materiale (ose relevante)

¹⁵ Më në fund të sigurt? Ligji dhe praktika në shtetet anëtare të BE-së në lidhje me azilkërkuesit që ikin nga dhuna pa dallim. 5.4.3. "Për shkak të": Lidhja midis cënimit dhe dhunës pa dallim në një situatë konflikti të armatosur (f.60), i disponueshëm në: <https://www.unhcr.org/4e2d7f029.pdf>

Identifikimi i fakteve materiale (ose relevante), apo atyre fakteve që lidhen drejtpërdrejt me përkufizimin e refugjatit, siç parashikohet në nenin 1 A (2) të Konventës së Gjenevës 1951 dhe në dispozitat e ligjit shqiptar, është hapi i parë në shqyrtimin e një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare. Në identifikimin e fakteve materiale (ose relevante), Autoriteti përgjegjës merr parasysh:

- **deklaratat dhe dokumentet në lidhje me profilin personal të kërkuarit** (d.m.th. moshë, statusi familjar dhe social (nëse është relevante), përkatësia etnike, feja, gjinia, shtetësia, vendet dhe zonat në të cilat ka qëndruar, dokumentet e identitetit, dokumentet e udhëtimit, etj.);
- **historia personale e rrëfyer** (kush, çfarë, ku, si, kur dhe pse), duke i kushtuar vëmendje çdo persekutimi ose cënimit të rëndë të pësuar, periudhat e ndalimit eventuale, arrestimet ose kërcënimet e vuajtura nga aplikuesi ose nga anëtarët e familjes, keqtrajtimi, tortura dhe shkelje të tjera të të drejtave të njeriut (duke përfshirë aktet e diskriminimit) si dhe autorët dhe arsyet e persekutimit ose cënimit të rëndë;
- **frika e persekutimit ose cënimit të rëndë** në rast të kthimit në vendin e tij/saj të origjinës ose të vendbanimit të zakonshëm të mëparshëm;
- **dokumentacioni** (p.sh. dokumentet gjyqësore, fotot, kartat e partisë, vërtetimet, etj.) të paraqitura nga Kërkuari në mbështetje të fakteve/rrethanave të rrëfyerë;
- **të gjitha faktet relevante në lidhje me vendin e origjinës së kërkuarit** (duke përfshirë ligjet dhe rregulloret dhe zbatimin e tyre) kur merret një vendim për kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare.

Përmbajtja dhe qëllimi i vlerësimit të kredibilitetit

Qëllimi i vlerësimit është të përcaktojë nëse elementet e dhëna nga kërkuari gjatë intervistës së tij/saj janë të besueshme në dritën e informacionit që disponon Autoriteti përgjegjës si dhe të profilin individual të kërkuarit, duke përfshirë aspektet e vulnerabilitetit që mund të ndikojnë mbi kredibilitetin e tij/saj. Më konkretisht, vlerësimi i kredibilitetit synon të përcaktojë nëse dhe cila nga deklaratat e kërkuarit mund të konsiderohet e besueshme dhe, për rrjedhojë, të merret parasysh në analizën e frikës së bazuar të persekutimit dhe të cënimit të rëndë.

Parimet që duhen zbatuar gjatë vlerësimit të kredibilitetit:

- vlerësimi i kredibilitetit do të kryhet në **mënyrë individuale, të paanshme dhe objektive**;
- **barra e provës** nga kërkuari dhe më pas **barra e bashkëpunimit** nga intervistuesi: Kërkuari ka barrën të bëjë çdo përpjekje për të vërtetuar kërkesën e tij/saj për azil, në bashkëpunim me Autoritetin. Ndërsa Autoriteti ka një detyrim bashkëpunimi, të vendosur me ligj, i cili merr formën e identifikimit të fakteve materiale/relevante, kërkimit të elementeve që mund të vërtetojnë këto fakte (duke kërkuar informacione/prova të mëtejshme nga kërkuari dhe kërkime nga jashtë burimet, nëpërmjet COI), si dhe në barrën për të kërkuar sqarime nga kërkuari në lidhje me çdo rrethanë që duket kontradiktore ose mospërputhëse në lidhje me të tjerat;
- **vlerësimi i bazuar në profilin individual** dhe kontekstin të cilit kërkuari i përket (mosha, niveli arsimor, prejardhja sociale dhe kulturore, kushtet psikofizike në momentin e intervistës, etj.);
- **vlerësimi i bazuar në prova objektive** (d.m.th. deklaratat dhe dokumentet e kërkuarit, COI, gjuha e folur dhe njohuritë e territorit, etj.) dhe të mos bazohet në supozimet, stereotipet, intuitat ose besimet personale të intervistuesit;
- **vlerësimi i të gjitha provave në dispozicion**, të cilat duhet të merren parasysh në tërësi, pa anashkaluar asnjë aspekt të spikatur;
- **saktësia**: shqyrtimi kryhet në mënyrë të kujdesshme dhe rigorozë;
- **përfitimi i dyshimit (benefit of doubt)**: mund të ndodhë që, pas mbledhjes së të gjitha fakteve dhe elementeve të nevojshme për vendimin, të mbeten dyshime për kredibilitetin e një elementi. Në këtë rast, përfitimi i dyshimit mund të zbatohet, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në ligj, përfshirë përpjekjen e vërtetë të bërë nga kërkuari për të mbështetur kërkesën (pika 5 e nenit 31).

Indikatorët

Vlerësimi i kredibilitetit kryhet nëpërmjet referencës praktike të indikatorëve të kredibilitetit¹⁶, që janë:

- **detaje dhe specifika të mjaftueshme të rrëfimit;**
- **konsistenca e brendshme:** moskontradikta ndërmjet elementeve faktike të rrëfimit dhe ndërmjet dokumentacionit të paraqitur, konsiderohet si tregues efektiv i kredibilitetit. Megjithatë, kontradiktat duhet të konsiderohen të rëndësishme vetëm nëse vënë në pikëpyetje kredibilitetin e pasazheve të spikatura të rrëfimit dhe jo aspektet marginale të tij;
- **konsistenca e jashtme:** mungesa e kontradiktave ndërmjet fakteve materiale të transmetuara nga Kërkuesi dhe informacionit të disponueshëm për kontekstin e origjinës (COI);
- **probabiliteti:** ky është një tregues mjaft i diskutueshëm, i cili duhet të merret parasysh me vëmendje të veçantë, pasi, sado e pazakontë apo edhe e pamundur të duket një ngjarje për intervistuesin ose vendimmarrësit, ajo mund të jetë e besueshme në kontekstin e origjinës së kërkuesit, për shkak të variablave socio-kulturore, politike, antropologjike të vendit të origjinës së kërkuesit. Pabesueshmëria në vetvete nuk mund të konsiderohet si shenjë e mosbesueshmërisë, veçanërisht kur çfarë ka thënë kërkuesi nuk është kundërshtuar nga informacioni i disponueshëm.

Shqyrtimi i kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare me procedurë të përshpejtuar

[Pikat 1, 2 dhe 5 te nenit 34 dhe pika 3 e nenit 51, të Ligjit 10/2021]

Sipas ligjit “Për azilin” dhe **VKM nr. 201, datë 6.4.2022** “Për kushtet, kriteret dhe afatet për përcaktimin e procedurës së përshpejtuar për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare”, Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të marrë vendim për zbatimin e procedurës së përshpejtuar, në përputhje me parimet dhe garancitë themelore të përcaktuara në këtë ligj, lidhur me rastet kur:

- vendim pozitiv, në rastet kur është i bazuar në dëshmitë në dispozicion (procedura e thjeshtuar) ose
- vendimi negativ, në rastet kur një kërkesë konsiderohet e papranueshme ose e pabazuar.

Në këto raste, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, me vendim të arsyetuar, vendos refuzimin e kërkesës, brenda 15 ditëve nga paraqitja e saj. **Procedura e përshpejtuar NUK zbatohet për kërkuesit që kanë nevojë për garanci procedurale të veçanta**¹⁷.

Parametrat proceduralë për përjashtim nga e drejta e mbrojtjes ndërkombëtare

[Pikat d), e), dhe f) te nenit 1 te Konventes se 1951; Nenit 19 dhe 21 të Ligjit 10/2021]

Pas një vlerësimi pozitiv të përfshirjes në statusin e refugjatit, mund të jetë e nevojshme të kryhet një analizë shtesë, që synon të verifikojë ekzistencën e ndonjë arsyeje përjashtimi, ose të atyre rrethanave, për të cilat një person *edhe pse ndodhet në kushtet që do të kishte të drejtë për njohjen e statusit të refugjatit* – duhet të përjashtohet. Megjithatë, ky vlerësim nuk do të jetë i nevojshëm në rast se shqyrtimi i përfshirjes ka përfunduar negativisht dhe Kërkuesi nuk bie në përkufizimin e një refugjati; për këtë arsye, **vlerësimi i përjashtimit, si rregull, duhet të bëhet pas vlerësimit të përfshirjes.**

Për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e klauzolave të përjashtimit nga statusi i refugjatit dhe, në veçanti, për çështjet interpretuese në lidhje me çdo rast individual përjashtimi, të konsultohen:

¹⁶ Për më shumë informacion, ju lutemi referojuni UNHCR, *Përtej Provës. Vlerësimi i kredibilitetit në sistemet e azilit të BE-së*, maj 2013, në disponueshëm në: <https://www.unhcr.org/51a8a08a9.pdf> ; Për më shumë informacion mbi COI, ju lutemi referojuni: ECOI, *Common EU Guidelines for processing Country of Origin Information (COI)*, prill 2008; EASO, *Country of Origin Information (COI) Report Methodology*, qershor 2019; Udhëzuesit praktik të EASO-s mbi përdorimin e informacionit të vendit të origjinës nga zyrtarët e rasteve për shqyrtimin e kërkesave për azil, dhjetor 2020, i disponueshëm në: https://euaa.europa.eu/sites/default/files/publications/EASO_Practical_guide_COI_EN.pdf

¹⁷ Udhëzues praktik EASO: *Kualifikimi për mbrojtjen ndërkombëtare*, Prill, 2018. I disponueshëm në: <https://euaa.europa.eu/sites/default/files/easo-practical-guide-qualification-for-international-protection-2018.pdf>
Autoriteti përgjegjës përdor informacionin nga burime të ndryshme, si EASO dhe UNHCR dhe organizatat ndërkombëtare përkatëse të të drejtave të njeriut.

- UNHCR - Udhëzimet për Mbrojtjen Ndërkombëtare Nr. 5: Zbatimi i Klauzolave të Përjashtimit: Neni 1F i Konventës së 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve, 4 shtator 2003, HCR / GIP / 03/05, i disponueshëm në: <https://www.unhcr.org/publications/legal/3f7d48514/guidelines-international-protection-5-application-exclusion-clauses-article.html>
- UNHCR - Shënim mbi Zbatimin e Klauzolave të Përjashtimit: Neni 1F i Konventës së 1951 lidhur me Statusin e Refugjatëve, 4 shtator 2003, i disponueshëm në: <https://www.refworld.org/docid/3f5857d24.html>;
- Adresimi i shqetësimeve të sigurisë pa minuar mbrojtjen e refugjatëve - këndvështrimi i UNHCR-së, i disponueshëm në: <https://www.refworld.org/docid/5672aed34.html>;
- Udhëzuesi praktik i EASO: Përjashtimi, Janar 2017, i disponueshëm në [https://euaa.europa.eu/sites/default/files/EASO%20Practical%20Guide%20https://euaa.europa.eu/sites/default/files/EASO%20Practical%20Guide%20Exclusion%20\(final%20for%20ëb\).pdf](https://euaa.europa.eu/sites/default/files/EASO%20Practical%20Guide%20https://euaa.europa.eu/sites/default/files/EASO%20Practical%20Guide%20Exclusion%20(final%20for%20ëb).pdf).

Në vlerësimin e zbatimit të klauzolave të përjashtimit është e rëndësishme të ndiqen disa masa procedurale:

- kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare i arsyeye të përjashtimit të përmendura në Art. 1 F **duhet të jetë veçanërisht i kujdesshëm**, pasi efekti i tij konsiston në përjashtimin nga mbrojtja ndërkombëtare e një personi që është konsideruar tashmë në rrezik të ndjekjes penale në rast riadhesimi;
- **parimi i proporcionalitetit**: graviteti i krimit në fjalë peshohet në lidhje me pasojat e përjashtimit;
- **barren e provës e mban Shteti**. Në konstatimin e fakteve dhe rrethanave nga të cilat mund të lindë zbatimi i klauzolave të përjashtimit, do të jetë e mundur të jepet përfitimi i dyshimit;
- **standardi i provës duhet të kalojë prapun e ‘arsyeve serioze për të besuar’**, dhe për këtë arsye kërkohen prova të qarta, të besueshme dhe të sigurta.

V – ANKIMIMI

V.1 Afatet kohore brenda të cilave mund të bëhet ankimimi

[Pika 3 neni 34, neni 58, pikat 1 dhe 2 neni 76, nenet 77 dhe 80 të Ligjit 10/2021]

Ligji i garanton kërkuessit (si dhe personit që gëzon statusin e refugjatit, mbrojtje plotësuese ose mbrojtje të përkohshme) të drejtën e ankimimit në Komisionin Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët kundër vendimeve të Autoritetit përgjegjës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit. Nëse Kërkuessi, për shkak të arsyeshme, nuk mund të dorëzojë ankimin brenda afatit ligjor, mund të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit. Ligji përcakton se zbatohen edhe dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative. Gjithashtu, ligji i njeh mundësinë kërkuessit, që të ankimohet edhe kundër vendimit të AP për kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare në procedurën e përshpejtuar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit.

Ligji 10/2021 “Për azilin” gjithashtu specifikon se i huaji, kërkesa e të cilit është refuzuar nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët, nuk dëbohet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë përpara ushtrimit apo dhënies së mundësive ligjore për ushtrimin e të drejtave procedurale dhe garancive të parashikuara me ligj.

V.2 Mundësi për ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti

(Neni 58 i Ligjit 10/2021, Udhëzimi nr. 39, datë 16.3.2022)

- Kërkuessve të mbrojtjes ndërkombëtare ju mundësohet ndihmë juridike e garantuar nga shteti, në lidhje me:
- asistencë në hartimin e dokumenteve;
- përfaqësimin në procedurën pranë Autoritetit përgjegjës;

- përgatitjen e ankimeve kundër vendimeve të marra gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe;
- para një gjykate për qëllime të ankimit të vendimeve të marra gjatë shqyrtimit të kërkesës së tyre.
- Megjithatë ligji specifikon që ndihma juridike e garantuar nga shteti ¹⁸do t'u ofrohet kërkuarve që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për të mbuluar shpenzimet përkatëse.

Për sa i përket Komisionit Kombëtar, i cili është organi administrativ epror që shqyrton ankimet e bëra ndaj vendimeve të Autoritetit përgjegjës, si rregull, vendos për ankimin brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, me përjashtim të ankimeve të paraqitura kundër vendimeve të marra në bazë të neneve 35 (*kërkesa e papranueshme*) dhe 36 (*kërkesa dukshëm e pabazuar*) të ligjit “Për azilin”, ku afati për marrjen e vendimit, është 15 ditë nga data e paraqitjes së ankimit.

V.3 Ankimi në gjykatën administrative

[Pika 4 e nenit 34, pika 3 e nenit 76 dhe pika 4 e nenit 47 të Ligjit 10/2021]

Ligji “Për azilin” u ofron kërkuarve mundësinë e ankimit kundër vendimeve të Autoritetit përgjegjës dhe/ose vendimeve të Komisionit Kombëtar pranë gjykatës administrative kompetente. Ankimi në gjykatë pezullon ekzekutimin e vendimit.

V - KOMPETENCA TË TJERA TË AUTORITETIT PËRGJEGJËS SE AZILIT DHE REFUGJATËVE

Menaxhimi i marrëdhënieve me Kërkuar dhe përfaqësuesit ligjorë

[Pikat 5 dhe 5/1 të nenit 27 të Ligjit 10/2021]

Ligji “Për azilin” i garanton përfaqësuesit ligjor të kërkuar, akses në informacionet (*të pranishme në dosjen e tij/saj*), të cilat janë të rëndësishme për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare. Ligji parashikon gjithashtu që një akses i tillë mund t'u mohohet përfaqësuesve ligjorë kur zbulimi i informacionit ose burimeve do të rrezikonte sigurinë kombëtare, marrëdhëniet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë ose kur interesat e hetimit në lidhje me shqyrtimin e kërkesës preken negativisht. Megjithatë, përjashtimisht, aksesit në informacione mund t'i lejohet një përfaqësuesi ligjor i cili është i pajisur me certifikatë të sigurisë për njohjen e informacionit të klasifikuar.

Marrëdhëniet e AP me Qendrën e Pritjes për Azil (QPA):

[Pika 8 neni 30, pika 1 neni 43, pika 3 neni 44, pika 1 neni 46, pikat 2 (b) dhe 3 neni 47, pikat 1 dhe 2 neni 48 të Ligjit 10/2021]

Siç parashikohet nga ligji “Për azilin” në fuqi, shtetasi i huaj, apo personi pa shtetësi, i cili pas intervistimit nga PKM kategorizohet kërkuar i mbrojtjes ndërkombëtare, transferohet në Qendrën e Pritjes për Azil, ku ka të drejtë të qëndrojë deri në momentin kur merret vendimi përfundimtar. Qendra e Pritjes ka detyrimin të informojë Autoriteti përgjegjës për procedurat në lidhje me hyrjen, qëndrimin ose largimin e kërkuarve për mbrojtje ndërkombëtare, në ambientet e saj. Në rastin e kërkuar, për të cilin Autoriteti përgjegjës dyshon se mund të jetë i papërshtatshëm ose nuk mund të intervistohet (*për shkak të rrethanave të paqëndrueshme jashtë kontrollit të tij/saj*) konsultohet me personelin e Qendrës së Pritjes dhe kërkon një mendim të specializuar dhe të certifikuar nga institucionet mjekësore kompetente mbi gjendjen e tij¹⁹.

¹⁸ Ndhmën juridike mund ta japin ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për ndihmën juridike të garantuar nga shteti (Pika 3 e nenit 58 të Ligjit 10/2021).

¹⁹ Kontrollat mjekësore të kryera për këto qëllime do të paguheshin me fonde publike dhe refuzimi i aplikantit për t'iu nënshtruar një ekzaminimi të tillë mjekësor nuk e pengon Autoriteti përgjegjës të marrë vendim lidhur me kërkesën e tij/saj për mbrojtje ndërkombëtare. Shkëmbimi i informacionit dhe modalitetet e bashkëpunimit ndërmjet autoritetit përgjegjës për azilin dhe

Gjithashtu, Autoriteti përgjegjës, nëse e çmon të rëndësishme, për vlerësimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, mund të kërkojë që kërkuesi (*me aprovimin e tij/saj*) t'i nënshtrohet një kontrolli mjekësor për shenja që mund të vërtetojnë persekutimin ose cënimin e rëndë të pësuar. Kontrolli mjekësor koordinohet dhe monitorohet nga personeli i Qendrës së Pritjes dhe rezultatet e ekzaminimit, të vërtetuara nga një mjek i kualifikuar, i dorëzohen Autoritetit përgjegjës.

Komunikimi i Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët me UNHCR

[Neni 6; pika 3 e nenit 10; pika 2 e nenit 22; pika 2 e nenit 27; pika 1 (d) e nenit 29; pika 4 (a) e nenit 31; pika 4 e nenit 33 dhe pika 3 e nenit 82 të Ligjit 10/2021]

Me synimin për të siguruar bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe UNHCR-së në përputhje me nenin 35 të Konventës së Gjenevës të 1951, autoritetet shqiptare do të bashkëpunojnë me UNHCR-në gjatë gjithë procedurës për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga autoriteti përgjegjës. Autoriteti përgjegjës duhet të:

- t'i dërgojë UNHCR-së listën e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare të shqyrtuara nga Autoriteti përgjegjës dhe çdo ankesë të paraqitur, si dhe çdo informacion tjetër që kërkohet;
- t'i kërkojë UNHCR-së opinione ose rekomandime të natyrës së përgjithshme, si dhe rekomandime për raste të veçanta;
- të lejojë UNHCR-në të ketë kontakte me kërkuenin (*me kërkesën e tij/saj*), duke përfshirë edhe ata në paraburgim;
- t'i sigurojë UNHCR-së (*me aprovimin paraprak të kërkuetit*) qasje në informacione për kërkesat individuale, mbi ecurinë e procedurave dhe vendimet e marra pas përfundimit të tyre;
- të lejojë UNHCR-në të paraqesë pikëpamjet e saj tek autoritetet përgjegjëse për trajtimin dhe shqyrtimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare, në çdo fazë të procedurës;
- të lejojë një përfaqësues të UNHCR-së të marrë pjesë në intervistën personale (*me aprovimin paraprak të kërkuetit*);
- t'i komunikojë UNHCR-së një kopje të vendimit brenda pesë ditëve nga data e marrjes së tij;
- të përdor informacion të saktë dhe të përditësuar të përpunuar nga UNHCR: për të shqyrtuar kërkesat ndërkombëtare (*përfshirë ato të mbrojtjes së përkohshme*) si dhe për të vlerësuar nëse një vend është një vend i tretë i sigurt.

REFERENCA:

LEGJISLACIONI SHQIPETAR

Ligjit 10/2021 'Per Azilin ne Republiken e Shqiperise';

- Urdhër nr. 244, date 03.06.2021 "Për miratimin e formatit të vertetimit te mos shqyrtimit te kerkeses per mbrojtje nderkombetare ne Republiken e Shqiperise";
- Udhëzimi Nr. 245 of 03.06.2021 "Per rregullat dhe procedurat per marrjen e informacionit dhe verifikimin e te dhenave e te deklarimeve nga vendi i origjines per azilkerkuesin dhe refugjati";
- Udhëzimi nr. 246, datë 03.06.2021 "Për procedurën dhe afatin për marrjen e vendimit të pushimit të shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë";
- Urdhri nr. 247 date 03.06.2021 "Per Percaktimin e procedurave dhe rregullave te dergimit te kerekeses per mbrojtje nderkombetare nga autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin tek autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët";

refugjatët dhe UNHCR-së do të përcaktohen në një marrëveshje ndërmjet ministrisë përgjegjëse për çështjet e azilit dhe refugjatëve dhe UNHCR-së.

- Urdhri nr. 248 datë 03.06.2021 “Për miratimin e formatit të vërtetimit mbi dorëzimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”;
- Urdhri nr. 249, datë 03.06.2021 “Për miratimin e formularit të kërkesës për bashkim familjar në Republikën e Shqipërisë”;
- Urdhri nr. 250, datë 03.06.2021 “Për përmbajtjen dhe mënyrën e administrimit të Rregjistrit elektronik të azilkërkuesve dhe personave në mbrojtje ndërkombëtare”;
- Udhëzimi nr. 39, datë 16.3.2022 “Për modalitetet e nevojshme organizative dhe teknike për ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti kërkuar për mbrojtje ndërkombëtare”.
- Udhëzimi Nr. 269 datë 01.07.2021 “Për përcaktimin e procedurës së regjistrimit në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të vitit 2010, të refugjatit ose personit në mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë”.
- Vendim Nr. 669, datë 10.11.2021 “Për kriteret e emerimit, shkaqet e lirimit apo të shkarkimit, si dhe shperblimi i anetareve të Komisionit Kombëtar për azilin e refugjatit”.
- Vendimi nr. 855, datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kushteve minimale të jetesës dhe të kushteve sociale për kërkuar të mbrojtjes ndërkombëtare”.
- Vendimi nr. 630, datë 27.10.2021 “Për organizmin dhe funksionimin e Qendrës së Pritjes për Azil”.
- Vendimi nr. 201, datë 06.04.2022 “Për kushtet, kriteret dhe afatet për përcaktimin e procedurës së përsheptuar për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare”.

Ligji Nr. 79/2021 “Per te huajt”

- Udhëzimit Nr. 293, të 04.06.2015, “Mbi Procedurat e Trajtit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

LEGJISLACIONI NDERKOMBETAR

- Konventa e Gjenevës të 1951 dhe të Protokollit të 1967 në lidhje me Statusin e Refugjatëve;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventes Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Nju Jork, 20 nëntor 1989
- Komenti i Përgjithshëm nr. 14 (2013) mbi të drejtën e fëmijës që interesi i tij/saj më i lartë të merren si konsideratë parësore (neni 3, par. 1), 29 maj 2013.

DIREKTIVAT E BE

- Direktiva 2011/95/EU
- Direktiva 2013/32/EU
- Direktiva 2013/33/EU.

DOKUMENTA DHE UDHËZUES TË UNHCR-së

- UNHCR, *Manual mbi Procedurat dhe Kriteret për Përcaktimin e statusit të Refugjatit dhe Udhëzimet për Mbrojtjen Ndërkombëtare sipas Konventës së 1951 dhe Protokollit të 1967 në lidhje me Statusin e Refugjatëve*, Prill 2019;
- UNHCR, *Standardet Procedurale për Përcaktimin e Statusit të Refugjatit sipas Mandatit të UNHCR-së*, 26 gusht 2020;
- Të drejtë dhe të shpejtë: Dokumenti Diskutues i UNHCR-së mbi Procedurat e Përsheptuara dhe të Thjeshtuara në Bashkimin Evropian;
- Më në fund të sigurt? Ligji dhe praktika në shtetet anëtare të BE-së në lidhje me azilkërkuesit që ikin nga dhuna pa dallim;

DOKUMENTA DHE UDHËZUES TË EUAA (ish-EASO)

- Udhëzuesi Praktik EASO: *Intervistë personale*
- Udhëzuesi praktik EASO: *Vlerësimi i provave*

- Udhëzues praktik EASO: *Kualifikimi për mbrojtjen ndërkombëtare*;²⁰
- Udhëzuesi praktik i EASO: *Përrjashtimi*
- Country of Origin Information (COI) *Report Methodology*;
- Udhëzuesi praktik i EASO-s *Mbi përdorimin e informacionit të vendit të origjinës nga zyrtarët për shqyrtimin e kërkesave për azil*

Aneksi I

²⁰ *Kualifikimi për të përfituar mbrojtjen ndërkombëtare* është mjet praktik që shoqëron zyrtarët e ngarkuar me trajtimin e dosjeve brenda Bashkimit Evropian edhe përtej në punën e tyre të përditshme.

Plani i intervistës

Profili i azilkërkuesit dhe kërkesa për azil

Emri, nënshtetësia, mosha, gjinia, etnia, besimi fetar, situata familjare, niveli arsimor, nevojat e veçanta, dokumentet, Përmbledhje e kërkesës për azil

Shtrirja kohore



Për t'u qartësuar

- | | | |
|--|---|--|
| ☐ Identiteti dhe origjina | ☐ Kërkesa për azil | ☐ Rreziqet e ardhshme |
| ☐ Mbrojtje shtetërore | ☐ Mbrojtje e brendshme | ☐ Dalja nga vendi i origjinës |
| ☐ Situata shëndetësore | ☐ Arsytet për përjashtim | ☐ Problemet me besueshmërinë |

Faza e hapies

- ☐ Tema 1
- ☐ Tema 2
- ☐ ...

Faza e rrëfimit të lirë

- ☐ *[Dëqioni rrëfimin e lirë mbi kërkesën për azil]*
- ☐ Plotësoni shtririen kohore
- ☐ Rreziqet e ardhshme
- ☐ Përmbledhni arsyet e kërkesës për azil

Faza e hulumtimit

- ☐ Tema 1
- ☐ Tema 2
- ☐ ...
- ☐ Thellohuni në problemet me besueshmërinë, nëse është nevoja

STRATEGJIA E INTERVISTËS

Kur ndërtoni strategjinë e intervistës, duhet t'u përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme:

- Cili informacion është i rëndësishëm për kërkesën?
- Cilat probleme ju duhet të hulumtoni dhe në ç'radhë?
- Ç'prova ose informacion bazë keni?
- Cila është vlera e këtij informacioni ose prove?
- Cilin informacion doni të përdorni në mënyrë strategjike (kur dhe si do t'ia bëni me dije azilkërkuesit se e keni këtë informacion)?
- A ka probleme me besueshmërinë; cila mund të jenë shpjegimet e mundshme alternative?
- Për çfarë duhet ta pyesni azilkërkuesin që të eliminoni shpjegimet e tjera të mundshme, pa dëmtuar provën?
- Si do t'ia jepni azilkërkuesit mundësinë për të dhënë informacion përmes një rrëfimi të lirë (rrëfimi i lirë jep më shumë informacion të besueshëm se sa përgjigjet ndaj një serie të gjatë pyetjesh, prandaj është më i preferuar)?
- Ç'nivel detajesh prisni të jepet gjatë intervistës?
- Si dhe kur do t'i bëni të ditura problemet me besueshmërinë?
- Çfarë di azilkërkuesi se ç'informacion keni?
- Për çfarë mendon azilkërkuesi se do ta pyesni?
- Ç'pyetje pret azilkërkuesi që t'i bëhen?

Aneksi II

FORMULAR PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT TE REFUGJATIT (për t'u plotësuar nga intervistuesi)



Numri i dosjes _____

Numri i veçantë _____

Data e regjistrimit _____

Aplikanti / Personi kujdestar që e shoqëron

1. Emri i plotë : _____

Emri i plotë në gjuhën e aplikantit : _____

2. Mashkull Femër

3. Datëlindja (dita, muaji, viti) : _____

4. Gjendja civile: i/e pamartuar __, i/e martuar __, i/e divorcuar __, i/e ve __

5. Vendlindja (qyteti, lokaliteti, shteti) : _____

6. Kombësia / Shtetësia :

7. Vendi i fundit i banimit (qyteti, lokaliteti, shteti) :

8. Data e nisjes që nga vendi i origjinës : _____

9. Shtetet në të cilat aplikanti ka qëndruar që nga largimi prej vendit të origjinës :

a) Shteti :

Nga / deri në :

b) A keni aplikuar për status refugjati në ndonjë nga këto shtete?
 Po . / Jo . Nëse po, jep hollësira : _____

c) A u pranua aplikimi juaj? Po . / Jo .
 Nëse po, jep hollësira : _____

10. **Data e hyrjes në vendin ku kërkohet azil :** _____

11. **Adresa e tanishme :** _____

12. **Aftësitë gjuhësore :** 1. Gjuha amtare:
 2. Gjuhë të tjera :

13. **Arsimimi dhe punësimi :**

a) Shkolla fillore (nga / deri në) :

b) Shkolla e mesme (nga / deri në) :

Vendi :

c) Universiteti (vendi) : _____

Dega : _____ Nga / deri në : _____

Emri i gradës / diplomës / certifikatës që është marrë : _____

d) Trainime (vendi)

e) Emri i institucionit trainues.

f) Lloji i kursit Nga / deri në : _____

Emri i gradës / certifikatës / diplomës së marrë : _____

e) Punësimi / aftësitë :

f) Punësimi i fundit në vendin e origjinës :

Nga / deri në

g) Të dhëna për punësimin (në 10 vitet e fundit) :

Emri dhe adresa e punëdhënësit	Lloji i punës	Nga / deri në
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

14. Anëtarët e familjes që shoqërojnë aplikantin :

Emri i plotë	Datëlindja	Lidhja me aplikantin
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____
_____	_____	_____

15. A jeni rregjistruar ju në Konsullatë, ambasadë apo në ndonjë autoritet tjetër në shtetin tuaj ?

Po Jo

Nëse po, jep hollësi : _____

16. A mbani ju një dokument identifikimi ?

Pashaportë	Çertifikatë udhëtimi	Dokument udhëtimi
Dokumentet e Konventës së Udhëtimit		ICRC Dokument Udhëtimi
Çertifikatë	Kartë identiteti	Të tjera (shpjegojini)


Ju lutem, bashkëngjitni fotokopjen e dokumentit / dokumentave dhe plotësoni faqen e hollësishme :

Numri	Lëshuar nga	Data	Afati
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____

17. Anëtarë të familjes që për momentin jetojnë në vendin e origjinës :

(bashkëshorti, bashkëshortja, nëna, babai, djali, vajza, vëllai ose motra e pamartuar)

Emri i plotë	Datëlindja	Lidhja me aplikantin	Profesioni
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____
_____	_____	_____	_____



1) Emri i plotë _____

2) Lidhja me aplikantin _____

3) Datëlindja

4) Adresa

5) Statusi _____

19. Pse u larguat nga shteti juaj ?

Shpjegoni me hollësi duke përkthuar çdo ngjarje të veçantë dhe përvojë vetjake si edhe masat e marra ndaj jush ose anëtarëve të familjes suaj, të cilat u bënë shkak për largimin nga shteti juaj. Nëse keni ndonjë dokument apo provë tjetër në lidhje me sa më sipër, ju lutemi ta bashkëngjitni. Nëse ka nevojë për më shumë hapësirë, përdorni një fletë të veçantë.

[illegible]

20. Përmend emrin e ndonjë organizate politike, fetare, ushtarake, etnike ose shoqërore ose ndonjë grupimi të cilit i përkisni ju ose ndonjë anëtar i familjes suaj në shtetin tuaj :

21. Përshkruani veprimtarinë tuaj (ose të anëtarëve të familjes suaj) dhe përgjegjësitë në organizatën / organizatat e mësipërme: _____

22. **A jeni përfshirë ju ndonjëherë në incidente me dhunë fizike ?** Nëse po, përshkruani natyrën e incidentit dhe rolin tuaj :

23. A keni qenë ndonjëherë i arrestuar ose i dënuar ? Po Jo

Nëse po, jep arsyen, datën dhe vendin :

24. A keni qenë ndonjëherë i burgosur ? Po Jo

Nëse po jepni të dhënat në vijim.

Periudha e burgosjes : _____

Vendi: _____

Hollësi të tjera : _____

25. A është shërbimi ushtarak i detyrueshëm në vendin tuaj? Po Jo

Nëse po, a ju kanë thirrur për të kryer shërbimin ? _____

Periudha e shërbimit ushtarak : _____

Nëse ju kanë thirrur por nuk keni shkuar jepni arsyen tuaj :

26. A dëshironi të ktheheni në shtetin tuaj për momentin ? Po Jo

Nëse jo jepni arsyet : _____

27. Çfarë mendoni se mund t'ju ndodhë juve në rast se ktheheni atje dhe pse ?

Formulari pasi lexohet dhe gjendet në rregull firmoset pa vëretje nga të pranishmit:

Emri i azilkërkuesit :

Firma e azilkërkuesit :

Emri i intervistuesit :

Firma e intervistuesit :

Udhëzues për përcaktimin e Statusit të Refugjatit

Emri i përkthyesit :

Firma e përkthyesit :

Data :

Vendi :

Ora :

Aneksi III: Vendimi i gjatë dhe i shkurtuar nga Autoriteti Pergjegjes për Azilin dhe Refugjatët



VENDIM Nr. _____ Datë _____. _____._____

PËR NJOHJEN E “STATUSIT TË REFUGJATIT” NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Sot më datë __. __. ____, Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme mori në shqyrtim kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë të kërkuarit **Emër Mbiemër**. Ky Autoritet pasi shqyrtoi faktet dhe çështjen në tërësi, konstatoi:

Subjekti: EMËR MBIEMËR

Emri:
Mbiemri:

Datëlindja:
Gjinia:

Udhëzues për përcaktimin e Statusit të Refugjatit

Atësia:
Kombësia:
Shtetësia:

Vendlindja:
Gj. Civile:
Arsimi:

Baza ligjore: Ligji 10/2021, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe Konventa e Gjenevës e vitit 1951 dhe Protokollin e vitit 1967 në lidhje me Statusin e Refugjatëve.

Elementët e refugjatit:

Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët pasi shqyrtoi çështjen në tërësi vlerëson se janë shfaqur arsye thelbësore për të besuar se ky shtetas përmbush kriteret për t’ju njohur Statusin e Refugjatit në Republikën e Shqipërisë. **Z. xxxxxxxx** lindur në xxxxxx, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, **për arsye të anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror**, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së saj dhe nuk ka mundësi dhe dëshirë për të kërkuar mbrojtjen e atij vendi.

V E N D O S I:

Njohjen e Statusit të Mbrojtjes Plotësuese në Republikën e Shqipërisë, për z. bazuar në Ligjin 10/ 2021, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, bazuar në nenin 76/1 të ligjit 10/2021, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatëve, brenda 15 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

DREJTOR I AUTORITETIT

Specialist

Specialist

Specialist

Specialist



ARSYETIMI I VENDIMIT TË SHTETASIT

EMËR MBIEMËR

Sot më datë DD.MM.YY, Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme mori në shqyrtim kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë të kërkuarit **emer mbiemer**. Ky Autoritet pasi shqyrtoi dokumentacionin, faktet e ndodhura në dosje dhe çështjen në tërësi, konstaton :

I. Subjekti.

Z.

Emri:

Mbiemri:

Atësia:

Seksi:

Vendlindja:

Datëlindja:

Arsimi:

Gj. Civile:

Kombësia:

Shtetësia:

- I. Baza ligjore:** Neni 40 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligji 10/2021, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe Konventa e Gjenevës i vitit 1951 dhe Protokollin e vitit 1967, në lidhje me Statusin e Refugjatëve.

III. Përmbledhje e hapave procedurale.

- Hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë, (data dhe vendi i hyrjes)**
- Nga Formulari i Përzgjedhjes të Shtetasve të Huaj të Parregullt**
(të citohet data kur personi rezultoi kërkuar për mbrojtje ndërkombëtare;
- Shqyrtimi i kërkesës për përcaktimin e Statusit të Refugjatit** bazuar në pikën “1”, të nenit 27 dhe pika 1 dhe 2 e nenit 31 të Ligjit të Azilit (shënohet data e shqyrtimit të kërkesës);

Kërkuari ka parashtruar faktet lidhur me kërkesën e tij bazuar në pikën 1 të nenit 30 të LPA, në gjuhën (shënohet gjuha që flet kërkuari në prani të një përkthyesi të mundësuar nga Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët);

IV. Deklarimi i fakteve.

Faktet e çështjes

Këtu të jepet një përmbledhje e fakteve të parashtruara nga kërkuari.....

IV. Vendimi

Qenia i/e huaj

Të specifikohet identiteti i kërkuarit dhe citohen dokumentat e tij të identifikimit, (nëse i disponon ato).

Arsyëtimi

Në këtë pjesë jepet arsyëtimi i bërë nga kërkuari nëse plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për njohjen e statusit të refugjatit. Sipas specifikimit që jep Ligji 10/2021, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, pika 28 e nenit 3 të këtij ligji jep përkufizimin e termit “Refugjat”, ku citohet se;

“Refugjat është i huaji apo personi pa shtetësi, i cili, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së tij ose vendit të zakonshëm të banimit dhe nuk ka mundësi ose dëshirë për të kërkuar

mbrojtjen e atij vendi apo kthimin në atë vend, si pasojë e këtyre rrethanave, në përputhje me kriteret e nenit 1(A) të Konventës së Gjenevës.”

Nga shqyrtimi i çështjes në tërësi Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët vlerëson nëse kërkuesi i plotëson të gjithë elementët e parashikuar nga ky ligj për dhënien e statusit të refugjatit në Republikën e Shqipërisë, pra kur persekutimi apo cënimi serioz, vjen për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes së tij politike.

Nëse kërkuesi nuk plotëson kriteret e parashikuara nga legjislacioni për statusin e Refugjatit por plotëson kushtet për njohjen e statusit të Mbrojtjes Plotësuese sipas përkufizimit në pikën “19” të nenit 3 të Ligjit 10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se;

“Mbrojtja plotësuese” është formë mbrojtjeje që i jepet shtetasi të huaj ose personit pa shtetësi, që nuk i përmbush kriteret për të fituar statusin e refugjatit dhe ka arsye serioze e të bazuara të mendohet se në rast kthimit të tij në vendin e origjinës apo në rastin e personit pa shtetësi në vendbanimin e tij të zakonshëm të mëparshëm, ai rrezikon realisht të përballët me cenime të rënda dhe nuk ka mundësi, apo për shkak të rrezikut të tillë nuk dëshiron të përfitojë nga mbrojtja e atij vendi., atëherë këtu do listohen arsyet e paraqitura nga kërkuesi dhe të vlerësuara nga autoriteti si të besueshme për tju njohur ky status, duke i analizuar si me poshtë:

Elementët e mbrojtjes plotësuese:

Frika e bazuar e kërkuesit:

Elementi objektiv (duhet të shtjellohet ky element duke u bazuar në situatën e përgjithshme të vendit të origjinës dhe në kushtet e kërkuesit).

Këtu është e rëndësishme të citohen edhe informacionet e mbledhura nga ky autoritet mbi vendin e origjinës së kërkuesit (COI) dhe të vednoset edhe linku ku është marrë ky informacion si dhe Qëndrimi i UNHCR-së, si dhe referimet në raporteve ndërkombëtare mbi situatën aktuale në vendin e origjinës së kërkuesit.

Elementi subjektiv (të shtjellohet ky element, ku në përgjithësi kërkon që kërkuesi të ndiejë një frikë përndjekje, qëndrimi i tij ndaj mundësisë së kthimit në vendin e origjinës duhet të tregojë një ankth, as të shtirur e as të ekzagjeruar, por të arsyeshëm e të singertë).

Përndjekja dhe shkella e të drejtave të njeriut

Mendime të ndryshme ngrihen mbi çështjen nëse dhunimi i këtyre të drejtave të njeriut arrin në një shkallë të tillë sa të përbëjë përndjekje, persekutim apo cënim serioz. Dhunimi i të drejtave të tilla, si e drejta e jetës, e drejta e lirisë dhe e sigurisë, e drejta e ushtrimit lirisht të besimit fetar dhe praktikave fetare ose e mos ushtrimit të tyre, përbën persekutim. Të gjitha këto të drejta janë thelbësore për çdo qenie njerëzore dhe mbrohen nga Konventat e ndryshme të ratifikuara edhe nga shteti shqiptar.

Disa nga dispozitat kryesore të parashikuara në akte ndërkombëtare të ratifikuara nga R. Sh. që lidhen me çështjen.

Neni 3 i Konventës Europiane për te Drejtat e Njeriut shprehet se: *“Askush nuk mund ti nënshtrohet torturës apo dënimit apo trajtimit poshtëruës e çnjerëzor”*

Neni 7 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike shprehet se: *“Askush nuk do ti nënshtrohet torturës dhe as dënimeve ose trajtimeve mizore, çnjerëzore e poshtëruëse. ... ”*

Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët duhet të ketë gjithmonë në fokus **parimin e moskthimit**²¹ sipas gërmës “b”, të pikës “1” të nenit 11 të ligjit 10/2021, ‘Për Azilin në Republikën e Shqipërisë’.

Mungesa e Mbrojtjes Shtetërore:

Në vlerësimin e gjendjes së azilkërkuesit duhet të shihet edhe mundësia e tij për të përfituar nga mbrojtja e vendit të origjinës. Për këtë ai duhet të përmbushë edhe kriteret e mospasjes së dëshirës për t’u kthyer në vendin e origjinës dhe për të patur mbrojtjen e atij vendi. Ky kriter duhet të analizohet në të dy kuptimet e tij:

- Mospasjen e dëshirës për t’u kthyer në vendin e shtetësisë, duke patur frikë se do t’i nënshtrohet persekutimit;
- Pamundësinë e shtetit të saj për t’i ofruar një mbrojtje efektive ndaj persekutimit të mundshëm;

Për sa më sipër Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët vlerëson se janë shfaqur arsye thelbësore për të besuar se ky shtetas i përmbush kriteret për t'ju njohur Statusi i Refugjatit /Mbrojtjes Plotësuese në Republikën e Shqipërisë (sipas rastit).

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në (këtu do të citohet baza ligjore ku autoriteti vendos në njohjen e statusit të Refugjatit apo të Mbrojtjes Plotësuese në Republikën e Shqipërisë (sipas rastit).

V E N D O S I:

Njohjen e Statusit të Mbrojtjes Plotësuese në Republikën e Shqipërisë, për z. **Emër Mbiemër**

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, bazuar në nenin 76/1 të ligjit 10/2021, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatëve, brenda 15 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

AUTORITETI PËRGJEGJËS PËR AZILIN DHE REFUGJATËT

Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001 Tiranë

IV.3 Shqyrtimi i kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare me procedurë të përshpejtuar

[Pikat 1, 2 dhe 5 të nenit 34 dhe pika 3 e nenit 51, të Ligjit 10/2021]

Sipas ligjit “Për azilin” dhe **VKM nr. 201, datë 6.4.2022** “Për kushtet, kriteret dhe afatet për përcaktimin e procedurës së përshpejtuar për shqyrtimin e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare”, Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët mund të marrë vendim për zbatimin e procedurës së përshpejtuar, në përputhje me parimet dhe garancitë themelore të përcaktuara në këtë ligj, lidhur me rastet kur:

- vendim pozitiv, në rastet kur është i bazuar në dëshmitë në dispozicion (procedura e thjeshtuar) ose
- vendimi negativ, në rastet kur një kërkesë konsiderohet e papranueshme ose e pabazuar.

Në këto raste, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, me vendim të arsyetuar, vendos refuzimin e kërkesës, brenda 15 ditëve nga paraqitja e saj. **Procedura e përshpejtuar NUK zbatohet për kërkuesit që kanë nevojë për garanci procedurale të veçanta²².**

²² Udhëzues praktik EASO: *Kualifikimi për mbrojtjen ndërkombëtare*, Prill, 2018. I disponueshëm në: <https://euaa.europa.eu/sites/default/files/easo-practical-guide-qualification-for-international-protection-2018.pdf>
Autoriteti përgjegjës përdor informacionin nga burime të ndryshme, si EASO dhe UNHCR dhe organizatat ndërkombëtare përkatëse të të drejtave të njeriut.